



RAPORT SHQYRTUES

“Falimentimi i shoqërive të sigurimit dhe konsumatori”

Autorë:

Neritan Kallfa¹, Rinald Guri, Teuta Baleta²

Tiranë, Mars 2020

¹ Avokat, ekspert i të drejtës tregtare.

² Ekspertë të fushës së tregjeve financiare, si dhe rregullimit e mbikëqyrjes së tyre.

Ky raport shqyrtues është përgatitur në kuadër të programit “*Mbrojtja e të drejtave social ekonomike*”, pjesë e projektit operacional “Rrjeti i Avokatëve”.

Koordinator: Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë
Vendi: Tiranë
Kohëzgjatja: nëntor 2019 - mars 2020
Lloji i punimit: Raport Shqyrtues
Grupi i punës: Av. Neritan Kallfa, Ph.D., Rinald Guri, Teuta Baleta,
Mbështetja financiare: Fondacioni Shoqëria e Hapur Për Shqipërinë

Opinionit i shprehur në këtë raport shqyrtues është personal i autorëve dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht pozicionin zyrtar të Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë.

PËRMBAJTJA

I. Hyrje	5
II. Analiza e legjislacionit	7
III. Një analizë ballfaqese me standardin ndërkombëtar	20
IV. “Fatura” e falimentit	34
V. Përfundime dhe rekomandime	39
IV. Referenca	42

Shkurtime

AMF ose Autoriteti, ose rregullator, ose mbikëqyrës	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
BE	Bashkimi European
BSHS ose Byroja	Byroja Shqiptare e Sigurimeve
IAIS	Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve
ICP ose standardi	Parimi Bazë i Sigurimit
Ligji falimentimit	Ligji 110/2016, datë 27.10.2016 “Për falimentimin”
Ligji konkurrencës	Ligji 9121 datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
Ligji i konsumatorit	Ligji nr. 9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”
Ligji sigurimit të detyrueshëm	Ligji nr. 10076, datë 12.02.2009 "Për Sigurimin e Detyrueshëm në Sektorin e Transportit"
Ligji sigurimeve	Ligji 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”
Ligji shoqërive tregtare	Ligji Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”
Mld	Miliardë
Mln	Milionë
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
Shoqëri / veprimtari sigurimi	Shoqëri / veprimtari sigurimi dhe risigurimi

I. HYRJJE

Shoqëritë e sigurimeve, mund të hyjnë në faza problematike për qëndrueshmërinë e biznesit të tyre dhe madje mund të kalojnë në paaftësi paguese, si edhe çdo biznes në çdo sektor tjetër të ekonomisë.

Paaftësia paguese e një shoqërie sigurimi, në varësi edhe të përmasave që merr ngjarja, sjell pasoja për ekonominë, tregjet financiare, shoqërinë në tërësi dhe veçanërisht konsumatorët. Prandaj synimi i autoriteteve rregullatore dhe mbikëqyrëse të tregut financiar, përfshi edhe tregun e sigurimeve, është që minimalisht të ketë një kuadër ligjor/rregullator dhe sisteme që amortizojnë pasojat e falimentimit. Madje, për shkak të veçantisë në raport me konsumatorin, proceset e ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe të falimentimit i nënshtrohen rregullimeve të veçanta, shpeshherë duke parashikuar ligje ose dispozita të posaçme në ligjin e fushës apo edhe duke i përjashtuar nga veprimi i ligjit të përgjithshëm mbi falimentimin, që zbatohet për subjektet e tjera.

Në rastin e Shqipërisë, pavarësisht rregullimeve të ligjit për falimentimin, për veprimtarinë e sigurimeve dhe për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit ka dispozita të veçanta. Si rregull, dispozitat ligjore duhet të rregullojnë në tërësi këtë situatë dhe duhet të shoqërohen edhe me një kuadër të plotë e të hollësishëm rregullativ, të miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF), me synim minimizimin e rreziqeve dhe pasojave.

Deri më sot (histori pothuaj 20-vjeçare e tregut të sigurimeve në Shqipëri) vërehet se:

- *Kuadri ligjor nuk është i plotë*, pasi ligjet në fuqi nuk i rregullojnë plotësisht dhe në mënyrë të harmonizuar elementet e falimentimit të shoqërive të sigurimit;
- *Kuadri rregullator nuk është zhvilluar mjaftueshëm*, pasi nuk rregullon mjaft aspekte procedurale dhe nuk është i shoqëruar me krijimin e garancive të nevojshme për procesin. Falimentimi i një siguruesi që shkruan sigurim të detyrueshëm motorik mund të çojë pa përjashtim në paaftësi paguese të një pjese të konsiderueshme të tregut të sigurimeve. Ndërsa, për sigurimet vullnetare nuk janë parashikuar përgjegjësi ligjore për kompensim pas një falimenti;
- *Nuk ka praktikë/përvojë të rregullatorit apo të gjykatës në procese të ndërhyrjes së jashtëzakonshme / falimentimi në shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit*, gjë që mund ta çojë procesin në ngërç ose ta zgjasë në kohë, duke rritur kostot e ndërhyrjes së jashtëzakonshme / falimentimit;
- *Situata e tregut të sigurimeve është akute* (sipas shifrave zyrtare të AMF). Raporti i aftësisë paguese të tregut nga 60% në 2016 ka arritur në 28% në 2017, që do të thotë se tregu si i tërë zotëron aftësi paguese për të mbuluar vetëm 28% të detyrimeve aktuale. Pra, në treg ka operatorë që tashmë kanë gërryer jo vetëm kapitalet e veta, por edhe të tregut. Aftësia paguese e tregut pas efektit të gërryerjes vlerësohet të jetë me përafërsi afro 2 mld lekë, nga 3.6 mld lekë që duhet të ishte minimumi ligjor për ushtrimin e veprimtarisë. Pra, nëse falimenton një ose disa operatorë,

që përfaqësojnë bashkërisht afro 20% të totalit të volumit të primeve të shkruara bruto të tregut, pra operator i mesëm, praktikisht i tërë tregu përballet më një mungesë kapaciteti absorbues ose dështim tërësor dhe ngërç likuiditeti;

- *Problematika që ka shoqëruar fondin e kompensimit* tregoi që janë konsumatorët viktimë ata që me shumë mundësi do të vuajnë pasojat e këtij skenari, duke pritur me dekada për marrjen e dëmshpërblimit.

Për rrjedhojë, studimi analizues dhe shqyrtues i rregullimeve në vend për procesin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme / falimentit është mëse i domosdoshëm. Ky shqyrtim ka rëndësi të ballafaqohet me praktikën dhe prirjet ndërkombëtare për të vlerësuar saktë zbrazëtitë që shfaq kuadri në Shqipëri dhe orientuar drejt ndërhyrjet përmirësuese.

II. ANALIZA E LEGJISLACIONIT

Një nga kolonat³ kryesore mbi të cilat ngrihet rregullimi ligjor i veprimtarisë së sigurimit dhe risigurimit është mbrojtja e konsumatorit.⁴ Kjo është e përcaktuar qartë që në objektin e ligjit për sigurimin.⁵

Tradicionalisht, përveç mekanizmave të mbrojtjes së konkurrencës,⁶ mbrojtja e konsumatorit ndjek një linjë tashmë të rregulluar në ligjin për konsumatorin. Kjo linjë është reflektuar edhe në ligjin për sigurimet dhe, siç do e shikojmë më poshtë, përfshin politikat tradicionale për mbrojtjen e konsumatorëve.⁷ Politikat dhe rregullimet tradicionale për mbrojtjen e konsumatorit përfshihen si më poshtë:

Edukimi i konsumatorëve: ndërgjegjësimi i konsumatorëve në lidhje me përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrimet e tyre; duke i ndihmuar ata për të luajtur një rol aktiv në treg; duke i mbrojtur konsumatorët nga kurthet dhe mashtrimi; duke i ofruar atyre një akses efektiv tek legjislacioni dhe mekanizmat zhdëmtues; duke i ndihmuar ata për të marrë vendime në lidhje me blerjet dhe shpërndarjen e buxhetit të tyre.

Informimi dhe këshillimi i konsumatorëve (mbi mallrat dhe shërbimet, rreziqet që lidhen me to, kushtet e kontratës, çmimet dhe tarifat, ligjet dhe aktet nënligjore etj.): etiketimin dhe amballazhimin e mallrave, njoftimet dhe udhëzimet e përdorimit, shpalljen e kushteve të kontratës, periudhat uljeve të çmimeve, ndalimin e publicitetit çorientues, promovimin e informimit të konsumatorëve nëpërmjet burimeve të pavarura, si grupet e konsumatorëve, zhvillimin e fushatave për ndërgjegjësimin e publikut, etj.

Mbrojtja e interesave ekonomikë të konsumatorëve: parandalimi i praktikave të padrejta të tregtimit, metodat e publicitetit dhe shitjes; eliminimi i kushteve të padrejta nga kontratat; rregullimi i spekulimit me çmimet; rregullimi i kredisë konsumatore; kreditë për shtëpi dhe transaksionet e tjera financiare; detyrimet në lidhje me garancinë pas shitjes; promovimi i standardeve të cilësisë etj.

³ Janë disa `kolona` mbi të cilat ngrihet e gjithë baza rregullatore e marrëdhënies së sigurimit dhe risigurimit. Një ndër këto është mekanizmi i ndërhyrjes së shtetit, për efekt të mbrojtjes së interesit publik, p.sh., stabiliteti financiar që rregullohet nga një sërë aktesh ligjore e nënligjore. Apo një kolonë tjetër është vetë marrëdhënia juridike civile e sigurimit dhe risigurimit që rregullohet nga Kodi Civil, kontrata, vendimet gjyqësore përfshirë standardet dhe praktikat ndërkombëtare, etj.

⁴ Konsumatori është përcaktuar në nenin 4(I)(20) të ligjit 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

⁵ Neni 1 i ligjit për sigurimin.

⁶ Ligji 9121 datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

⁷ Bourgoignie Th., Komentari i Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit.

Siguria e konsumatorëve: për të mbrojtur konsumatorët nga mallrat ose shërbimet, të cilat janë të rrezikshëm ose të pasigurtë nëpërmjet masave parandaluese (ato para tregtimit dhe ato pas tregtimit, si kërkesat për informim, skemat e sigurimit të cilësisë, detyrimeve të kontrollit gjatë proceseve të prodhimit dhe shpërndarjes, tërheqja dhe mbledhja e produkteve, sistemet për shkëmbimin e informacionit dhe dispozitat për mbikëqyrjen e tregut), sikurse edhe masat korrigjuese (duke i dhënë akses konsumatorëve tek skema më të përshtatshme dhe të thjeshta kompensimi, nëpërmjet rregullave strikte në lidhje me përgjegjësinë).

Masa mbrojtëse të konsumatorëve: ofrimi i mjeteve të shpejta dhe të thjeshta për konsumatorët që të ushtrojnë të drejtat e tyre; përcaktimi i masave të përshtatshme mbrojtëse civile, penale dhe administrative për konsumatorët; ofrimi i ndihmës ligjore për grupet e konsumatorëve ose të drejta për të ndërmarrë veprime pranë gjykatave; zhvillimi i skemave alternative.

Përfaqësimi i interesave kolektive të konsumatorëve: promovimi dhe ofrimi i mbështetjes për mbrojtjen e grupeve të konsumatorëve; rritja e pjesëmarrjes së përfaqësuesve të konsumatorëve në procesin e vendimmarrjes; themelimi i organeve këshillimore etj.

Akresi tek mallrat dhe shërbimet bazë: ofrimi p.sh., për të gjithë konsumatorët i aksesit efikas tek mallrat dhe shërbimet bazë si kujdesi shëndetësor, ushqimi, strehimi, uji, energjia, telekomunikacioni, transporti, edukimi dhe shërbimet financiare bazë.⁸

Por, në asnjë nga shënjestrat e kësaj linje tradicionale të mbrojtjes së konsumatorit nuk trajton mbrojtjen e konsumatorit në rastet kur ofruesi i shërbimit është në kushtet e paaftësisë paguese, si para procesit të falimentimit ashtu edhe pas këtij procesi nga likuidimi e deri në prishjen e shoqërisë.

Paaftësia paguese evidentohet në ligjin e sigurimeve por është vetëm me efekt rregullator, p.sh., synon të prandalojë situatën e paaftësisë paguese.⁹

Në fakt, kuptimi i paaftësisë paguese sipas ligjit të falimentimit është ndryshe nga kuptimi i paaftësisë paguese sipas aspektit rregullator në ligjin e sigurimeve. Ligji i falimentimit rregullon paaftësinë paguese kur kjo ka ndodhur realisht, pavarësisht nëse ligji për sigurimet apo aktet nënligjore mundohen ta shmangin një rrethanë të tillë. Pra, ligji falimentimit rregullon raportet dhe marrëdhëniet e një rrethane faktike paaftësie paguese. Gjithashtu, konstatohet se gjendja e paaftësisë paguese si kuptim është përcaktuar ndryshe në të dy ligjet: në ligjin e sigurimeve gjendja e paaftësisë paguese në kuptimin rregullator është e tillë kur nuk kënaqen kërkesat për nivelet e përcaktuara apo të përcaktueshme të kapitalit të shoqërisë së sigurimit; ndërsa në kuptim të ligjit të falimentimit gjendja e paaftësisë paguese evidentohet kur kreditori ka dështuar në ekzekutimin

⁸ Bourgoignie Th., Komentari i Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit.

⁹ Neni 75 dhe neni 80 i ligjit për sigurimin.

e një detyrimi (p.sh., pagese) në një procedurë të ekzekutimit të detyrueshëm gjatë periudhës së ekzekutimit vullnetar, sipas parashikimeve të nenit 517, të Kodit të Procedurës Civile.¹⁰

Në këtë raport nuk diskutohet apo debatohet paaftësia paguese në kuptimin rregullator sipas ligjit të sigurimeve, por diskutohet *pozita e konsumatorit në kushtet e paaftësisë paguese në kuptim të procesit të falimentimit*.

Pozicionimi i konsumatorit të tregut të sigurimeve në situatën e paaftësisë paguese të shoqërisë së sigurimit në kuptim të ligjit të falimentimit është shumë dimensional dhe midis këtyre dimensioneve përfshihet si më poshtë:

1) përqasja me ligjin për mbrojtjen e konsumatorit; nga ky këndvështrim synohet identifikimi i konsumatorit të mirëfilltë, që është vulnerabël dhe i papërgatitur për paaftësinë paguese të shoqërisë së sigurimit;

2) përqasja me Kodin Civil; nga ky këndvështrim synohet të vlerësohet sinkronizimi i pretendimeve kreditore të konsumatorit vulnerabël me radhën e përcaktuar në ligje të tjera, për shembull me atë të Kodit Civil apo me atë të ligjit të falimentimit. Por sidomos renditja në rendin e përparësisë së këtij konsumatori vulnerabël në listën e kreditorëve. Përfshirë edhe vlerësimin nëse ka statusin e një kreditori preferencial, si dhe mundësitë për kompesim për kredinë e tij përpara shpalljes së paaftësisë paguese;

Rregullimet nga këto këndvështrime mendojmë se duhet të jenë të qarta përpara se të fillojë procesi i falimentimit dhe ai i likuidimit, si faza përfundimtare drejt prishjes së shoqërisë së sigurimit. Këto janë dimensione që edhe vetë administratori i përkohshëm / likuidatori i shoqërisë së sigurimit, për sa kohë është një instrument në duart e rregullatorit, do duhet t'i ketë të qarta që në fillim, përpara se përgjegjësitë të mbeten në diskutim midis këtij administratori të përkohshëm / likuidatori dhe autoritetit rregullator.

II.1. Pozicioni i konsumatorit në raport me ligjin për konsumatorin

Fillimisht shqyrtojmë se ku ndodhet konsumatori i një shoqërie sigurimi në raport me ligjin për mbrojtjen e konsumatorit.

Nga vlerësimi evidentohen dy rrethana, të cilat krijojnë një paqartësi mbi trajtimin *ex post* të konsumatorit. E cilësojmë trajtimin *ex post* të konsumatorit, sepse është qëllim në vetvete në këtë raport për të evidentuar se si përgjigjet aktualisht sistemi pretendimeve kreditore të konsumatorit në një situatë të paaftësisë paguese të shoqërisë së sigurimit.

¹⁰ Neni 16, Ligji falimentimit.

Rrethana e parë është paqartësia e krijuar nga vetë përcaktimi i definicionit të konsumatorit në ligjin e sigurimeve, në raport me ligjin për konsumatorin. Në konceptimin e termit ‘konsumator’ ka një mospërputhje midis ligjit të sigurimeve dhe ligjit për mbrojtjen e konsumatorit. Këto përcaktime nuk janë të harmonizuara dhe kjo shkon në dëm të konsumatorit të shoqërisë së sigurimit. Në kuptim të ligjit të sigurimeve, “konsumator” është çdo person që përdor ose përfiton nga shërbimet e ofruara nga siguruuesi ose nga shërbimet e ndërmjetësimit.¹¹ Ndërsa, në kuptim të ligjit për mbrojtjen e konsumatorit, “konsumator” është çdo person, i cili blen ose përdor mallra apo shërbime për *plotësimin e nevojave vetjake, për qëllime që nuk kanë lidhje me veprimtarinë tregtare ose ushtrimin e profesionit*.

Në fakt ndryshimi është i qenësishëm. Në kuptim të ligjit të sigurimeve, konsumatori nuk e përjashton tregtarin, sado i madh apo i vogël qoftë ai. Ndërkohë, ligji për konsumatorin e përjashton tregtarin nga definicioni i konsumatorit. Në të vërtetë, termi gjithëpërfshirës në ligjin e sigurimeve nuk është në përputhje me thelbin e mbrojtjes së konsumatorit, sepse tregtari nuk është konsumator vulnerabël. Tregtari i ka mundësitë që të zgjedhë, të negociojë dhe të marrë produktin apo shërbimin nga shoqëria e sigurimit. Ndërsa konsumatori vulnerabël në kuptim të ligjit për mbrojtjen e konsumatorit nuk ka fuqi negociuese me palën siguruuese.

Gjithsesi, kjo i përket një vlerësimi më të thelluar nëse konsumatori në kuptim të veprimtarisë siguruuese është ‘njësoj’ si konsumatori i përcaktuar në ligjin për mbrojtjen e konsumatorit dhe nuk është objekt i këtij raporti. Por është dhe mbetet i rëndësishëm nga këndvështrimi i kompensimit, sepse nëse do mendohej një mekanizëm kompensimi i drejtpërdrejtë për mbrojtjen e konsumatorit në rastet e paaftësisë paguese të shoqërisë së sigurimit realisht do ishte një bazë shumë e gjerë ‘konsumatorësh’, ku përfshihen jo vetëm konsumatorët vulnerabël, por edhe tregtarët. Nëse diskutohet kompensimi do të duhej minimalisht të përkufizohej cili është kreditor apo kreditor i njohur, apo konsumator, apo konsumator vulnerabël (për shembull konsumatorët që janë realisht në pamundësi të negociojnë me shoqërinë e sigurimit). Por, edhe në atë grup konsumatorësh mbetet më tej të paravlerësohen edhe produktet më sensitive, për shembull konsumatorët vulnerabël, që kanë investuar apo blejnë polica sigurimi me të cilat sigurojnë raportet apo sendet jetike të konsumatorit. Pra, produkte të ngjashme me investimet financiare. Ndërsa nga krahu tjetër, tregtari do të duhet të përjashtohet nga koncepti i konsumatorit sipas ligjit të konsumatorit. Përveç mekanizmave të amortizimit të rrethave tregtare p.sh., rezervat në kapitalin e shoqërisë, tregtari i ka të gjitha mundësitë që nga zgjedhja e shoqërisë së sigurimit, vlerësimin e produkteve të sigurimit e deri te ekzekutimi në kohë i produkteve të sigurimit.

Rrethana e dytë që evidentohet qartë është se si ligji për sigurimet ashtu edhe ligji për mbrojtjen e konsumatorit trajtojnë vetëm rrethanat *ex ante*, d.m.th., përpara situatës së paaftësisë paguese të shoqërisë së sigurimit. Konstatohet se si ligji për sigurimet ashtu edhe ligji për mbrojtjen e

¹¹ Neni 4(I)(20) Ligji për sigurimet.

konsumatorit janë në një linjë: mbrojnë konsumatorin sipas kuptimit tradicional.¹² Por si ligji për mbrojtjen e konsumatorit ashtu edhe ligji për sigurimet nuk parashikojnë mbulimin apo kompesimin e dëmeve financiare të shkaktuara nga paaftësia paguese apo falimentimi i shoqërisë së sigurimeve.¹³

Pavarësisht mekanizmave mbrojtës, që në fakt janë për miradminstrimin e shoqërisë së sigurimit (p.sh., administrimi rreziqeve të veprimtarisë apo investimeve, kërkesat ligjore për kapitalit minimal, kapital të mjaftueshëm, likuiditet apo fond garancie etj.,) e deri te administrimi i përkohshëm ato janë *ex ante*, domethënë të natyrës parandaluese, dhe nuk janë të natyrës *ex post*, kur shoqëria e sigurimit është në kushtet e paaftësisë paguese. Pra, në kushtet e paaftësisë paguese deri në falimentimin e shoqërisë së sigurimit nuk ka rregullim konkret për administrimin e situatës së paaftësisë paguese të shoqërisë siguruese apo për kompesimin e palës së siguruar konsumatore vulnerabël. Në fakt, evidentohet një boshllëk ligjor për administrimin e paaftësisë paguese të shoqërisë së sigurimit në kuptim të ligjit të falimentimit, i cili përbën rrezik jo vetëm për palën e siguruar konsumatore vulnerabël, por edhe për të gjithë kreditorët e shoqërisë së sigurimit. Për shembull, për analogji me sistemin bankar, përveç kërkesave rregullatore për mjaftueshmërinë dhe cilësinë e kapitalit të bankës, evidentohen rregullime ligjore si për ndërhyrjen e rregullatorit për administrimin e jashtëzakonshëm të bankës në vështirësi financiare¹⁴ ashtu edhe rregullime ligjore për garantimin e pagesës së kompensimit të depozituesit për depozitat bankare në bankën me paaftësi paguese.¹⁵

II.2. Pozicioni i konsumatorit në radhën e preferimit të kreditorëve

Këtu shqyrtojmë se ku ndodhet konsumatori i shoqërisë së sigurimit në radhën e preferimit të kreditorëve.

Nga vlerësimi i pozicionit të konsumatorit në këtë dimension evidentohen disa problematika. Problematika e parë është se ligji i sigurimit dhe ligji i falimentimit nuk janë të harmonizuar me njëri-tjetrin. Këto dy ligje janë amenduar ndryshuar dhe riparë rishtazi gjatë viteve të fundit. Pra, këto ligje duhet të jenë objekt vlerësimi jo vetëm nëse janë apo jo të konsoliduara me njëri-tjetrin, por edhe nëse janë në përputhje me Kodin Civil. Në vlerësim të parë rezulton se nuk janë.

Së pari, formalisht ligji për sigurimet referon ligjin e falimentimit, tashmë të shfuqizuar. Konkretisht ligji për sigurimin¹⁶ përcakton se falimentimi i shoqërisë së sigurimit rregullohet nga

¹² Shiko referencën [7] më lart.

¹³ Përveç një referimi të përgjithshëm të ligjit 10076/2009 për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit neni 31.

¹⁴ Ligji 133/2016 “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka”.

¹⁵ Ligji 53/2014 “Për sigurimin e depozitave”.

¹⁶ Ligji 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

ligji 8901 datë 23.5.2002 “Për falimentimin”.¹⁷ Në fakt ky ligj është shfuqizuar nga ligji 110/2016 “Për Falimentimin”.¹⁸ Gjithashtu, ligji 110/2016 “Për falimentimin” e ka përcaktuar qartë se ky ligj nuk zbatohet për shoqëritë e sigurimit dhe procedurat lidhur me këto subjekte duhet të jenë të përcaktuara me ligj të posaçëm.¹⁹ Kështu që konstatohet lehtësisht se të vetmet rregulla të detyrueshme për zgjidhjen dhe shlyerjen kolektive të detyrimeve të shoqërisë së sigurimeve në një procedurë falimentimi janë ato të Kreut IX Seksioni IV të ligjit të sigurimeve. Në fakt, këto rregulla në ligjin e sigurimeve nuk kanë asnjë element procedural të administrimit të falimentimit të shoqërisë së sigurimit. Këto rregulla nuk përcaktojnë rolin e rregullatorit, organizimin e kreditorëve, rolin e administratorit të falimentimit, ndërhyrjen e gjykatës, koordinimin me procedurat e kodit të procedurës civile, etj., sepse ligji i sigurimeve këto çështje ia ka lënë rregullimit të ligjit për falimentimin.

Gjithashtu, duke u nisur nga parimet e përgjithshme të ligjit të falimentimit në rastet kur konstatohet paaftësi paguese e shoqërisë, fillimi i procedurave të falimentimit mund të sjellë si pasojë a) likuidimin dhe prishjen e shoqërisë pas përfundimit të procesit të falimentimit; ose b) ristrukturimin apo riorganizimin e shoqërisë si pjesë e procesit të falimentimit.²⁰ Në fakt, ligji për sigurimin rregullon vetëm trajtimin e një grupi kreditorësh nëse shoqëria e sigurimit shkon në likuidim. Ligji sigurimeve evidenton vetëm të siguarit apo përfituesit sipas kontratave të sigurimit²¹ pa ndarë veç konsumatorët vulnerabël nga jo konsumatorët dhe rregullon vetëm renditjen e këtij grupi kreditorësh, për shembull pa bërë dallimin ndërmjet konsumatorit vulnerabël nga tregtari apo pa marrë në konsideratë kreditorët e tjerë të shoqërisë së sigurimeve.²² Gjithsesi ky i fundit nuk është objekt i vlerësimit të raportit, sepse nuk vlerësohet rreziku i ekspozimit të personave të tretë kreditorë ndaj shoqërisë së sigurimit, por rreziku i ekspozimit të konsumatorit vulnerabël në kushtet e paaftësisë paguese të shoqërisë siguroese.

Problematika e dytë lidhet me konfuzionin në dallimin e konsumatorit vulnerabël nga kreditorët e tjerë të shoqërisë së sigurimit. Në radhë të parë konsumatori²³ i shoqërisë së sigurimit nuk është thjesht një kreditor²⁴ i shoqërisë së sigurimit. Konsumatori si një kreditor i mirëfilltë i shoqërisë së sigurimit ka dhe duhet të ketë të gjitha të drejtat si kreditorët e tjerë minimalisht. Ky konkluzion është rezultat i vetë faktit se në kontratën e sigurimit njëra palë, i siguruari konsumator duhet të ketë minimalisht një të drejtë pasurore apo jo-pasurore që duhet ta sigurojë nga rreziqet e mundshme.²⁵ Pra, pa u ndalur te deklarimi i plotë dhe i saktë i kësaj të drejte nga i siguruari, ky

¹⁷ Neni 182, 191, *ibid.*

¹⁸ Neni 209(1), *ibid.*

¹⁹ Neni 7(4), *ibid.*

²⁰ Ligji 110/2016 “Për Falimentimin”.

²¹ Neni 184, Ligji për falimentimin.

²² Neni 186, Ligji për falimentimin.

²³ Në varësi të përcaktimit të qartë dhe jo evaziv të konsumatorit.

²⁴ Neni 184, Ligji për sigurimet.

²⁵ Neni 1113 Kodi Civil.

konsumator me pagimin e primit të sigurimit për të siguruar të drejtën pasurore ose jo pasurore ka të drejtë të kërkojë pagesën nga pala siguroese nëse ndodhin rrethanat, të cilat janë parashikuar nga polica e sigurimit. Ndërsa, nga ana tjetër pala siguroese duhet të ketë zotësi të plotë juridike për të marrë përsipër të drejta dhe detyrime. Zotësia juridike e palës siguroese nuk është e plotë nëse është apo jo i licencuar nga autoriteti rregullator. Por mbi bazën e ligjeve dhe akteve nënligjore përcaktohet edhe aftësia paguese e palës siguroese për t'iu përgjigjur palës së siguruar konsumatore. Në thelb, marrëdhënia e sigurimit është ngritur mbi bazën e premtimit të shumës monetare nga pala siguroese për palën e siguruar me ndodhinë e rrethanave faktike për të cilat është paguar primi i sigurimit.²⁶ Gjithsesi, nga ky këndvështrim ligji i sigurimeve e ka të rregulluar.²⁷

Por, konfuzioni krijohet kur kërkon të evidentosh pozicionin e konsumatorit brenda vetë grupit të kreditorëve të shoqërisë së sigurimit në kushtet e paaftësisë paguese. Siç edhe evidentohet më poshtë, përveç faktit që përdoret herë termi `kreditor` e herë `kreditor i njohur`, konsumatori është në një pozicion të papërcaktuar brenda këtij grupi të paorganizuar dhe të papërcaktuar `kreditorësh` apo `kreditorësh të njohur`.

Sigurisht, burimi i parë dhe më i rëndësishëm për të veçuar konsumatorin nga kreditorët e tjerë do të ishte vetë ligji për sigurimin.²⁸ Por, ky trajtim specifik në këtë ligj ka disa sfida. Sfida e parë do ishte se ky trajtim bëhet për të gjithë kreditorët me pretendime dhe jo vetëm për konsumatorin e mirëfilltë, d.m.th., konsumatorin vulnerabël. Duke e përfshirë këtë konsumator në grupin gjithëpërfshirës të kreditorëve²⁹ do të ekspozonte konsumatorin përpara një trajtimi jo efikas dhe të drejtpërdrejtë, sepse kreditorët tregtarë me pretendime të mirëfillta tregtare do ishin më të përgatitur institucionalisht dhe teknikisht për të kushtëzuar shoqërinë e sigurimit përpara se të shpallej paaftësia paguese. Sfida e dytë është se trajtimi specifik në ligjin e sigurimeve është në një fazë më të vonuar në kohë që përkon me falimentimin. Pra, ka një mospërputhje midis referencave ligjore të ligjit të sigurimeve me ligjin e falimentimit, duke e bërë pjesën e falimentimit të shoqërive të sigurimit të paqartë juridikisht. Në këtë rrethanë, kreditorët dhe aq më tepër konsumatorët do të jenë përpara një situatë ku do t'i referoheshin Kodit Civil, neni 605. Përveç kredive që rrjedhin nga shpërblime për shkak vdekjeje e dëmtimi të shëndetit,³⁰ konsumatori i shoqërive të sigurimit nuk ka ndonjë përparësi në radhën e kreditorëve në raport me kreditorët e tjerë sipas Kodit Civil. Së treti, edhe nëse ligji i falimentimit që është në fuqi sot do ishte ligji përkatës për administrimin e procesit të falimentimit të shoqërive tregtare të sigurimit dhe trajtimin e pretendimeve kreditore, duhet patur parasysh se një konsumator i shoqërisë së sigurimit nuk është kreditor i siguruar dhe as kreditor i preferuar. Kështu që rrjedhimisht, nëse do ishte trajtimi sipas këtij ligji të falimentimit që është në fuqi, sot mbeten ose si kreditorë të tjerë, të tretët në

²⁶ Birds J., "Bird's Modern Insurance Law", Sweet & Maxwell, 1th Edition, fq. 23.

²⁷ Neni 184 Ligji sigurimeve.

²⁸ Neni 186 ligji sigurimeve.

²⁹ Neni 184 ligji sigurimeve.

³⁰ Neni 605(ç), Kodi Civil.

radhë, ose si kreditorë fundorë në radhën e katërt. Pra, në kushtet aktuale kur ligji për falimentimin sot nuk zbatohet, konkurren lista e preferimeve në ligjin për sigurimin dhe lista e preferimeve në Kodin Civil. Pavarësisht se lista e preferimeve sipas ligjit të sigurimit është lex specialis dhe sigurisht është bazë për trajtimin me përparësi të pretendimeve kreditore të shoqërisë së sigurimeve, mbetet ose kuptohet se do të mbeten si të tilla, pasi të përmbushen pretendimet kreditore sipas Kodit Civil (psh rrogat e punëmarrësve) përpara se të përmbushen detyrimet ndaj konsumatorëve sipas ligjit të sigurimeve.

Burimi i dytë për të veçuar konsumatorin nga kreditorët e tjerë, është procesi i likuidimit vullnetar apo të detyruar sipas ligjit të shoqërive tregtare. Fillimisht është e rëndësishme të cilësohet se likuidimi është faza e fundit përpara prishjes së shoqërisë. Në thelb, likuidimi në vetvete është një veprim `mekanik`. Likuidimi është një fazë e cila inicohet vetëm nëse sigurohet se a) pretendimet kreditore janë evidentuar saktë; b) shoqëria është në gjëndje të mirë financiare dhe i përmbush këto pretendime kreditore. Në rastin e likuidimit vullnetar thjesht likuidohen të gjitha pretendimet kreditore, përfshi edhe ato të ortakëve të shoqërisë. Ndërsa në rastin e likuidimit të detyrueshëm patjetër që kalon në fazën e falimentimit.

Procesi i likuidimit të shoqërisë së sigurimit vendoset nga ortakët dhe me miratim të autoritetit në rastet e likuidimit vullnetar apo nga autoriteti në rastet e likuidimit të detyrueshëm. Në të dyja rrethanat autoriteti do të duhet të ballafaqohet me vlerësimin e pretendimeve kreditore. Në rastin e parë në momentin e paraqitjes së kërkesës nga ortakët. Ndërsa në rastin e dytë që në momentin e vlerësimeve nga administratori i përkohshëm. Duke pasur parasysh se administrator i përkohshëm sipas ligjit të sigurimit mund t'i drejtohet si likuidimit vullnetar ashtu edhe atij të detyrueshëm mbetet të vlerësohet se konsumatori si një pretendues kreditor do kërkojë klasifikimin e pretendimeve të tij apo më tej likuidimin nëse është i pagueshëm.

Por, likuidimi i shoqërive të sigurimit është i lidhur ngushtë me natyrën e pretendimeve kreditore. E cilësojmë se natyra e pretendimeve kreditore jo detyrimisht mund të klasifikojë palën e siguruar si kreditorë. E para, ligji për shoqëritë tregtare nuk e përcakton qartë se kush është `kreditor` apo `kreditor i njohur` në një procedurë likuidimi. E dyta, nga vetë natyra e sigurimit i siguruari mund të bëhet kreditor nëse shoqëria e sigurimit detyrohet të paguajë me plotësimin e kushteve të policës së sigurimit.

II.3. Mbrojtja e konsumatorit në fazë likuidimi

Këtu shqyrtojmë pozicionin e konsumatorit në fazën e likuidimit dhe nëse ka mjete të mjaftueshme për mbrojtjen e të siguruarit-konsumator.

Fillimisht është e rëndësishme të evidentohet paraprakisht fakti se në kuptim të falimentimit të shoqërisë së sigurimit, likuidimi është gjithmonë një fazë përfundimtare e vetë procesit të falimentimit. Gjithashtu, është e rëndësishme të evidentohet se legjislacioni, ashtu si edhe në rastin

e falimentimit ku kemi kombinim të ligjit të sigurimeve me atë të falimentimit, edhe për likuidimin kemi kombinim të ligjit të sigurimit me ligjin e shoqërive tregtare. Në të dyja rastet, si për likuidimin vullnetar ashtu edhe për likuidimin e detyrueshëm, ligji për sigurimin i referohet për procedurë ligjit për shoqëritë tregtare.³¹

Pra, ashtu si edhe rasti i falimentimit, nga njëra anë kuptohet se përmbajtja, thelbi dhe materialisht likuidimi i shoqërisë së sigurimeve trajtohet sipas ligjit të sigurimeve. Ndërsa, nga ana tjetër kuptohet sikur procedura trajtohet nga ligji i shoqërive tregtare. Por, siç do e shikojmë edhe më poshtë, vetë procedura e likuidimit përmban procese të cilat janë të lidhura me përmbajtjen. Dhe përmbajtja në thelb ka të bejë me përcaktimin e saktë të pretendimeve kreditore (pra kreditorët apo te ashtuquajturit kreditorë të njohur) dhe trajtimin e këtyre pretendimeve në likuidim.

Pra, likuidimi i shoqërive të sigurimit rregullohet nga ligji për shoqëritë tregtare.³² Likuidimi në kuptim të ligjit për shoqëritë tregtare është kryesisht në kuptim të prishjes së shoqërisë tregtare dhe si i tillë, si likuidimi vullnetar³³ ashtu edhe ai detyrues³⁴ është vetëm në rastet kur shoqëria tregtare është në kushtet e aftësisë paguese. Por, pavarësisht se prezumohet se procesi i likuidimit shkon deri në përmbushjen e pretendimeve kreditore, d.m.th., pagesa dhe likuidimi i të gjithë kreditorëve të shoqërisë së sigurimit, mund të ndodhë edhe e kundërta që nga ky proces të evidentohet se shoqëria është në paaftësi paguese dhe, si e tillë, procesi i likuidimit pezullohet deri në konsumimin e procesit të falimentimit.³⁵

Por ç`ndodh realisht në një proces likuidimi dhe ku janë rrethanat që mund të devijojnë procesin drejt një procedure të detyruar falimentimi?

Prishja e shoqërisë kryhet nga ortakët³⁶ me një vendimarrje të karakterit të jashtëzakonshëm, për të cilën kërkohet një shumicë e cilësuar, si për kuorumin ashtu edhe për vendimarrjen. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga asambleja e përgjithshme. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, *çdo person i interesuar* mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.³⁷

Por procesi i likuidimit nuk mund të iniciohet vetëm nga ortakët apo autoriteti rregullator³⁸ por edhe nga personat e interesuar. Personat interesuar është një koncept gjithëpërfshirës dhe në rastin e shoqërive të sigurimit nuk përjashton palën e siguruar konsumatore. Gjithsesi, ky diskutim është

³¹ Neni 172 dhe neni 179 Ligji për sigurimet.

³² Ligji Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar (“Ligji Nr. 9901”) dhe nga Ligji nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar (“Ligji Nr. 9723”).

³³ Me iniciativën e ortakëve.

³⁴ Kur përcaktohet me ligj p.sh., dënim penal për prishjen e shoqërisë.

³⁵ Neni 190.1 Ligji Nr. 9901.

³⁶ Me vendim të asamblesë së përgjithshme të shoqërisë.

³⁷ Neni 191.2, Ligji Nr. 9901.

³⁸ Neni 175, Ligji për sigurimin.

i lidhur ngushtë me sqarimin nëse `personi i interesuar` në kuptim të ligjit për shoqëritë tregtare është `kreditor` në kuptim po të ligjit të shoqërive tregtare apo `kreditor i njohur` në kuptim të ligjit të sigurimeve.

Kështu, çdo `person i interesuar`, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës zëvendësimin e likuiduesit, nëse paraqet arsye të mjaftueshme për të dyshuar se likuidimi i rregullt i shoqërisë mund të cenohet nga likuiduesit e emëruar si më sipër. Kërkesa duhet të depozitohet në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e caktimit të likuiduesit. Nga ana e saj gjykata emëron likuiduesin, në rastet kur shoqëria tregtare prishet me vendim gjykate.³⁹ Së fundmi, likuiduesit shkarkohen dhe zëvendësohen me të njëjtat kushte, të parashikuara në dispozitat për emërimin e tyre.⁴⁰ Me hapjen e procedurave të likuidimit, emri i regjistruar i shoqërisë aksionare ndiqet nga shënimi “*në likuidim*”.⁴¹

Likuiduesit duhet të ftojnë kreditorët e shoqërisë për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj. Shoqëria e publikon dy herë këtë njoftim, me një interval prej 30 ditësh, në faqen e saj në internet, nëse ka, si dhe në faqen e internetit të QKB-së. Në njoftim duhet deklaruar se pretendimet duhet të depozitohen brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të fundit.⁴²

Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë,⁴³ mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve, duke respektuar radhën e përparësisë, sipas nenit 605 të Kodit Civil. Pra, është shumë e rëndësishme për një likuidues përcaktimi i saktë se cili është kreditor i shoqërisë dhe cili nuk është. Për shkak të vetë natyrës së likuidimit apo rolit të likuidatorit nuk do ishte në funksion të procesit që likuiduesi të kushtëzohej nga interpretimet apo qëndrime të papërcaktuara lidhur me `kreditorin` apo të `kreditorit të njohur` dhe aq më tepër të pretenduesit konsumator.

Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të tjera tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar. Nëse në bazë të pretendimeve të ngritura nga kreditorët,⁴⁴ likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit. Në kushtet aktuale kur falimentimi i shoqërive të sigurimit nuk rregullohet kjo përbën një mungesë thelbësore në sistemin aktual të likuidimit të pretendimeve kreditore.⁴⁵

Likuiduesi nuk mund të shpërndajë aktivet e mbetura të shoqërisë përpara përfundimit të afatit të

³⁹ Neni 192, Ligji Nr. 9901.

⁴⁰ Neni 193.1 *ibid.*

⁴¹ Neni 194.2 *ibid.*

⁴² Neni 195 *ibid.*

⁴³ Neni 197 *ibid.*

⁴⁴ Neni 195, *ibid.*

⁴⁵ Shiko më lart.

depozitimit të pretendimeve të kreditorëve, të përcaktuar sipas nenit 195 të këtij ligji.⁴⁶ Nëse një kreditor i shoqërisë, për të cilin likuiduesi është në dijeni, nuk kërkon të drejtat e veta, shumëat përkatëse depozitohen pranë gjykatës. Rregullat e përgjithshme për kontratën e depozitës janë të zbatueshme.

Përveç diskutimit mbi statusin e kreditorit mbetet që të sqarohen rrethanat se si likuidatori veçon dhe kujdeset për depozitimin e shumave në emër dhe për llogari të kreditorit. Por, ajo që është më e rëndësishme është se ***nëse një detyrim nuk mund të shlyhet menjëherë ose nëse është i debatueshëm***, aktivet mund të shpërndahen vetëm nëse kreditorit i është dhënë garanci e përshtatshme. Pra, fakti që `detyrimi që është i debatueshëm` është i përcaktuar edhe në ligj përkon me rrethanën e përcaktimit të `kreditorit` apo të të ashtuquajturit `kreditor i njohur`. Aktualisht nuk ka një përcaktim të drejtpërdrejtë apo konkludues në legjislacion për mbajtësin e policës së sigurimit, qoftë ky konsumator apo jo. Kjo jo vetëm vështirëson veprimet konkludente të likuidatorit, por njëkohësisht mund të sjellë si pasojë edhe pengimin e likuidatorit në përfundimin e procesit dhe likuidimin e kreditorëve që janë qartësisht të evidentuar.

Pas shlyerjes së detyrimeve të shoqërisë ndaj kreditorëve dhe shpërblimit të likuiduesit, së bashku me rimbursimin e shpenzimeve të këtij të fundit për kryerjen e detyrave, aktivet e mbetura u shpërndahen ortakëve ose aksionarëve.⁴⁷ Gjithashtu, pas shlyerjes së detyrimeve të shoqërisë ndaj kreditorëve, likuiduesit i paraqesin asamblesë së përgjithshme një raport për procedurën e likuidimit, për detyrimet e shlyera dhe për shpërblimin e tij. Nëse asambleja e përgjithshme miraton raportin, likuiduesit lirohen nga detyra dhe përfitojnë shpërblimin e përcaktuar në raport. Nëse raporti nuk miratohet, likuiduesit mund t'i drejtohen gjykatës me kërkesën për ta shkarkuar nga detyra, si pasojë e përmbushjes në mënyrën e duhur të detyrave. Pas shkarkimit të likuiduesit nga gjykata, ai ka të drejtë të përfitojë shpërblimin e përcaktuar në raport.

Pas shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve, likuiduesi u shpërndan ortakëve apo aksionarëve aktivet e mbetura, sipas të drejtave që ata kanë në ndarjen e fitimeve, me përjashtim të rastit kur statuti parashikon radhë preference.⁴⁸ Pasuritë, që i janë dhënë shoqërisë me qira apo në përdorim, me çfarëdo titulli u kthehen ortakëve apo aksionarëve. Ortakët apo aksionarët nuk kanë të drejtën e dëmshpërblimit në rast shkatërrimi, dëmtimi apo uljeje të vlerës së pasurisë, nëse kjo nuk varet nga veprimi apo mosveprimi i shoqërisë ose i personave, që kanë vepruar në emër të saj. Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton QKB-ne për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të Ligjit nr. 9723.⁴⁹

Veprimtaria e likuiduesit nuk mund të kundërshtohet pas çregjistrimit të shoqërisë nga QKB.⁵⁰

⁴⁶ Neni 199, Ligji Nr. 9901.

⁴⁷ Neni 200, *ibid.*

⁴⁸ Neni 201, *ibid.*

⁴⁹ Neni 202, *ibid.*

⁵⁰ Neni 203, *ibid.*

Likuiduesit përgjigjen ndaj kreditorëve për dëmet e shkaktuara gjatë procedurës së likuidimit, në përputhje me dispozitat që rregullojnë përgjegjësinë e administratorëve. Nëse ka disa likuidues, ata përgjigjen në mënyrë solidare. Krahas likuiduesve, ortakët e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe aksionarët përgjigjen ndaj kreditorëve të shoqërisë në mënyrë solidare deri në vlerën që u është shpërndarë, kreditorët, të cilët nuk kanë depozituar pretendimet e tyre në afat, sipas nenit 195, apo kreditorët, për të cilët likuiduesi nuk ka qenë dhe nuk mund të kishte qenë në dijeni, nuk kanë të drejtë të ngrenë padi. Këto padi duhet të ngrihen brenda 3 viteve pas çregjistrimit të shoqërisë nga QKB-ja.

Përveç procedurës së zakonshme të likuidimit parashikohet edhe likuidimi i thjeshtuar. Shoqëria tregtare mund të likuidohet nëpërmjet një procedure të përsheptuar, nëse kjo vendoset nga të gjithë ortakët apo aksionarët dhe kur këta deklarojnë përpara gjykatës përkatëse se të gjitha detyrimet e shoqërisë ndaj kreditorëve janë shlyer e janë rregulluar të gjitha marrëdhëniet me punëmarrësit.⁵¹ Në këtë lloj procedure administratorët janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga shkelja e detyrave të tyre gjatë likuidimit të thjeshtëzuar. Përveç administratorëve, ortakët apo aksionarët e shoqërisë përgjigjen në mënyrë solidare deri në shumat e marra. Paditë, duhet të ngrihen brenda 3 viteve nga data e çregjistrimit të shoqërisë nga QKB. Gjithsesi nuk është e qartë nëse procedura e likuidimit të thjeshtuar vepron mbi shoqërinë e sigurimit.

Pra, në fazën e likuidimit evidentohen dy ekspozime të mundshme. E para është që likuidimi në kushtet e paaftësisë paguese detyrimisht kërkon përfshirjen e procesit të falimentimit si fazë e domosdoshme përpara likuidimit të detyruar. Por, për sa kohë procedurat e falimentimit për shoqëritë e sigurimit mbeten akoma të parregulluara dhe të paplota procesi i likuidimit mbetet pezull. Pra, likuidimi mbetet një proces që është në pritje të përfundimit të procesit të falimentimit dhe rrjedhimisht në këto kushte mund të zgjatet duke dëmtuar të gjithë kreditorët përfshi edhe konsumatorin. E dyta është se në procesin e likuidimit në kushtet e paaftësisë paguese krijohen vështirësi lidhur me pozicionimin e konsumatorit në radhën e pagesave. Përveç pozicionimit të konsumatorit të shoqërisë së sigurimit në grupin e kreditorëve, mbetet të sqarohet nëse nuk kompensohen në të parë me ndonjë skemë ad hoc kompesimi mbetet të trajtohen sipas listës së preferimeve të ligjit të sigurimeve, e cila mbetet të integrohet, në mos pas kreditorëve të listës së preferimeve të Kodit Civil.

* *

*

⁵¹ Neni 204, *ibid*.

Si konkluzion, mund të thuhet se është i këshillueshëm jo vetëm rishikimi i dispozitave ligjore por edhe konsolidimi në disa plane i tyre, sepse evidentohet qartë se ligjet nuk janë të harmonizuara dhe përmbajnë elemente kontradiktore.

Evidentohet qartë se ligji i sigurimit nuk është përshtatur me ligjin e ri të falimentimit. Rregullimi ligjor për falimentimin e shoqërive të sigurimit mungon në legjislacionin aktual. Kjo përbën një rrezik evident për të gjithë kreditorët e shoqërive të sigurimit, përfshi edhe konsumatorin.

Gjithashtu, mungesa e rregullimit ekspozon sistemin në tërësi, përfshirë edhe autoritetin rregullator. Kjo mungesë krijon një hapësirë të parregulluar midis ndërhyrjes nga autoriteti rregullator përfshirë administrimin e përkohshëm deri në likuidimin e shoqërisë së sigurimit. Kjo hapësirë e parregulluar plotësisht krijon premisa për mos aplikimin e fazës së fundit, që është likuidimi dhe prishja e shoqërisë. Kjo situatë kërkon një vlerësim të menjëhershëm nga autoritetet publike për të plotësuar këtë vakuum ligjor.

Evidentohet gjithashtu qartë se ligji për sigurimin trajton vetëm aspektet tradicionale për mbrojtjen e konsumatorit. Rregullimet ligjore për mbrojtjen e konsumatorin duhet të jenë jo vetëm të harmonizuara por edhe të fokusuara drejt identifikimit të konsumatorit të mirëfilltë dhe vulnerabël në këndvështrim të mbrojtjes së tij në rast paaftësie paguese të shoqërisë së sigurimit.

Evidentohet qartë se përcaktimet ligjore mbi konsumatorin nuk janë të harmonizuara. Në rast se do konkludohet me krijimin e një skeme alternative të kompesimit të konsumatorit kur shoqëria e sigurimit është e falimentuar është e rëndësishme që të përcaktohet se cili është konsumator në kuptim të ligjit të sigurimeve. Përcaktimi aktual në ligjin për sigurimet ka kuptim vetëm në këndvështrimin tradicional të mbrojtjes së konsumatorit.

III. NJË ANALIZË BALLAFAQUESE ME STANDARDIN NDËRKOMBËTAR

Shtjellimi në seksionin II i tërësisë së legjislacionit shqiptar, të aplikueshëm në lidhje me trajtimin e konsumatorit në rastin e falimentimit të një shoqërie sigurimit, shqyrtohet më tej në krahasim me standardet e mbikëqyrjes së sigurimeve. Standardet e mbikëqyrjes së sigurimeve janë të formuluar në nivel ndërkombëtar nga organizatat profesionale, që në rastin e mbikëqyrjes së tregut të sigurimeve është Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS). Këto standarde shprehen në të ashtuquajturat parime bazë të sigurimeve (ICP), të zhvilluara sipas aspekteve të veçanta të sigurimeve.

Këto parime konsiderohen si korniza udhërrëfyese e pranuar në shkallë ndërkombëtare e parimeve, standardeve dhe udhëzimeve për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sektorit të sigurimeve të brendshëm të një vendi. E thënë ndryshe, ICP-të përbëjnë kuadrin e standardeve, nga i cili orientohen autoritetet mbikëqyrëse të tregut të sigurimeve për rregullimin dhe mbikëqyrjen e këtij tregu dhe drejt të cilit konvergjon përmbajtja e kuadrit ligjor dhe rregullativ përkatës të secilit vend.

Gjithashtu këto parime janë me natyrë dinamike dhe përmbajtja e tyre evoluon në shkallë të ndryshme për t'iu përshtatur zhvillimeve të industrisë së sigurimeve dhe nevojës për një mbikëqyrje sa më efektive. Nga pikëpamja formale ndryshimi shprehet në versionet e ndryshme të publikuara vit pas viti nga IAIS.

ICP 12 është standardi që trajton konceptin e daljes nga tregu të një shoqërie sigurimi. Nga pikëpamja e strukturës së formulimit, duhet theksuar se ICP hartohet në formë parimi, që shprehet në paragrafin kryesor të tekstit të ICP-së, në këtë rast paragrafi 12. Ndërkohë konceptet e këtij parimi shtjellohen në nënparagrafët e parimit, si dhe nënparagrafët hyrës udhëzues.

Sikurse u përmend në seksionin II të këtij punimi, paketa bazë ligjore që trajton çështjen e mbrojtjes së konsumatorit në rrethanat kur shoqëritë e sigurimit janë në vështirësi financiare apo në falimentim janë ligji për falimentin, ligji për sigurimet dhe ligji për sigurimet e detyrueshme, aktet nënligjore përkatëse, si dhe ligje të tjera si ai për shoqëritë tregtare, Kodi Civil etj.. Kjo nënkupton që ICP 12 të gjejë zbatim pikërisht në legjislacionin vendas (aktet ligjore dhe nënligjore) për të ofruar një kuadër standard të trajtimit të procesit të daljes nga tregu të shoqërisë. Për të vlerësuar shkallën e përputhshmërisë na duhet të analizojmë elementët e legjislacionit sipas frymës që përcakton ICP. Por përpara se të shtjellojmë këtë analizë, është me interes të shqyrtojmë se si ka ndryshuar vetë ICP 12.

III.1. Evoluimi i konceptit të ICP 12

Në përputhje me rëndësinë që ka për qëndrueshmërinë e tregut dhe mbrojtjen e konsumatorit ruajtjen e shëndetit financiar dhe aftësisë paguese të shoqërisë së sigurimit, përmbajtja dhe

konceptimi i ICP 12 ka evoluar në mënyrë të qenësishme nga versioni IAIS_ICPs 2018 (Standardi 18) në versionin IAIS_ICPs 2019, i publikuar në mars 2020 (Standardi 2019).

Sikurse e kemi theksuar më lart, ky raport shqyrtues ka si objekt pozicionin e konsumatorit në legjislacionin shqiptar në procesin e falimentimit të një shoqërie sigurimi. Megjithatë, në funksion të analizës së përmbajtjes së legjislacionit shqiptar, është e vlefshme të shtjellohet shkurtimisht evoluimi i përmbajtjes së ICP 12.

Tabelë 1: Ndryshimi i tekstit të ICP 12 (paragrafi i parimit)

IAIS_ICPs 2018	IAIS_ICPs 2019
<i>Titulli i ICP:</i> Prishja dhe dalja nga tregu	<i>Titulli i ICP:</i> Dalja nga tregu dhe ndërhyrja e jashtëzakonshme
Legjislacioni përcakton një gamë mundësish për daljen nga tregu të personave juridikë të fushës së sigurimeve (shoqëri sigurimi). Legjislacioni përcakton paaftësinë paguese, si dhe vendos kritere dhe procedura për të trajtuar paaftësinë paguese të shoqërive të sigurimit. Në rast të procedurave të prishjes së shoqërive të sigurimit, kuadri ligjor i jep përparësi mbrojtjes së policëmbajtësve (klientit) dhe synon të minimizojë ndërprerjen e ofrimit në kohë të përfitimeve për policëmbajtësin.	Legjislacioni përmban kërkesa për: <ul style="list-style-type: none"> ▪ daljen vullnetare të shoqërisë së sigurimit nga tregu; dhe ▪ ndërhyrjen e jashtëzakonshme për shoqëritë e sigurimit, të cilat nuk janë më të shëndetshme ose kanë të ngjarë të mos jenë më të shëndetshme dhe nuk kanë perspektivë të arsyeshme për t'u kthyer në gjendje të shëndetshme.

Që në titull të ICP-së kemi dallim thelbësor në fokusin e standardit. Standardi 18 trajton parimet mbi prishjen dhe daljen nga tregu të shoqërisë së sigurimit në bazë vullnetare apo të detyrueshme. Ky standard trajton shoqërinë e sigurimit që është në vështirësi financiare nga momenti kur shoqëria nuk mund të jetë më funksionale dhe si e tillë do të dalë nga tregu. Standardi 19 e zgjeron konceptin apo kuadrin e trajtimit të shoqërisë së sigurimit që është në vështirësi financiare dhe e shtrin jo vetëm në përgatitjen për daljen nga tregu (rruga pa kthim), por edhe në segmentin e veprimeve që mund të kryhen përmes mekanizmit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Standardi 18 kërkon që në thelb legjislacioni të përcaktojë qartë konceptet dhe procedurat e paaftësisë paguese dhe të daljes nga tregu të një shoqërie sigurimi, duke iu referuar individualisht shoqërisë së sigurimit si një person juridik, pra jo në konceptin e problemeve sistematike që mund të krijohen në kuadër të të gjithë tregut. Përveç përcaktimit të procedurave të qarta, Standardi 18 kërkon që legjislacioni t'i japë përparësi edhe mbrojtjes së policëmbajtësit, pra klientit apo konsumatorit të shoqërisë së sigurimit. Përparësia lidhet kryesisht me reduktimin në minimum të

pengimit së marrjes nga klienti të përfitimeve që rrjedhin nga polica, si dhe marrjes së këtyre përfitimeve në kohë.

Standardi 19, i zgjeruar së tepërmi edhe nga ana sasiore (teksti), po ashtu fokusohet në gamën e mekanizmave për daljen nga tregu të shoqërisë së sigurimeve, duke ndarë veçmas daljen vullnetare (e cila mund të kryhet edhe kur shoqëria është në gjendje të mirë financiare) me ndërhyrjen e jashtëzakonshme që ndërmerret nga rregullatori për shoqërinë e sigurimeve, që ndodhet në situatë të vështirë financiare.

Duke zhvendosur dhe zgjeruar fokusin për daljen nga tregu të shoqërisë, Standardi 19 përmban shumë më tepër kritere dhe koncepte që orientojnë legjislacionet e vendeve dhe veprimet e autoriteteve rregullatore.

Kështu, Standardi 19 fut konceptin⁵² e një *procesi*:

- të organizuar për daljen nga tregu të një shoqërie sigurimesh;
- që ndihmon në mbrojtjen e konsumatorëve (titullarëve të policave);
- që kontribuon në qëndrueshmërinë e tregut të sigurimeve dhe të sistemit financiar; si dhe
- që zhvillohet sipas regjimeve transparente dhe efektive.

Standardi 19 përkufizon “ndërhyrjen e jashtëzakonshme” si veprimin që ndërmerret nga autoriteti përgjegjës për ndërhyrjen e jashtëzakonshme kundrejt një shoqërie sigurimi që nuk është më, nuk ka të ngjarë apo nuk ka mundësi të jetë e shëndetshme. Në këtë koncept ndërhyrja e

⁵² Për shembull, banka qendrore e Holandës, që luan rolin e autoritetit përgjegjës për ndërhyrjet e jashtëzakonshme për shoqëritë e sigurimit që janë të dështuara, e përcakton ndërhyrjen e jashtëzakonshme si një proces i zhvilluar në mënyrë të kujdesshme dhe të kontrolluar për prishjen e një shoqërie sigurimi të falimentuar ose që ka të ngjarë të falimentojë. Kjo mënyrë ndërhyrjeje bëhet për të parandaluar që shoqëria e sigurimit që është në vështirësi të shkaktojë rrënim edhe në institucionet e tjera financiare ose që të ndërhyet me operacione shpëtimi duke përdorur fondet publike. Gjithashtu, kërkohet të sigurohet që policat e sigurimit të klientëve mbeten të vlefshme dhe klientët mbeten të siguruar.

Nga ana tjetër, Rumania ka një legjislacion të zhvilluar për ndërhyrjen e jashtëzakonshme, me mekanizma të mjaftueshëm dhe është nga të vetmet vende të BE-së që ka një fond financimi të ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Rumania kombinon, gjithashtu, fondin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme me fondin e garancisë, i cili financohet ex ante nga industria. Zhvillimi i këtij legjislacioni ka ardhur si pasojë e eksperiencave të kaluara me falimentimet apo gati falimentime në këto juridiksione, ku legjislacioni ka rezultuar i paplotë për t’u përballur me sukses dhe me kosto të arsyeshme për publikun. Rolin e autoritetit përgjegjës për ndërhyrjet e jashtëzakonshme e luan Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe ndërhyrja e jashtëzakonshme autorizohet kur plotësohen dy kushte: (i) shoqëria e sigurimit po falimenton ose ka të ngjarë të falimentojë; dhe (ii) ndërhyrja e jashtëzakonshme është në interesin e publikut sipas përcaktimeve në legjislacionin e fushës dhe në harmoni me rregullat e ndihmës shtetërore dhe të konkurrencës.

<https://www.dnb.nl/en/binaries/Factsheet%20Recovery%20and%20Resolution%20of%20Insurers.pdf>

jashtëzakonshme lidhet me një gamë veprimesh ndërhyrëse që kanë të bëjnë me transferimin e portofolit, *run-off*⁵³, ristrukturimin dhe likuidimin.

Standardi 19 përkufizon më qartë hierarkinë e mbulimit të humbjeve nga palë të ndryshme interesi, duke përcaktuar shprehimisht preferencën për konsumatorët, për të cilët përcakton se duhet të mbulojnë humbjet vetëm pasi të gjithë kreditorët e tjerë të preferencës më të ulët të kenë mbuluar humbjet në masën e plotë me pretendimet e tyre. Gjithashtu, standardi 19 në ndryshim nga standardi 18 sugjeron skemat e mbrojtjes së konsumatorëve për të zvogëluar më tej nevojën që humbjet të mbulohen prej tyre. Pra, standardi 19 *thekson qëllimin e mbrojtjes konsumatore në proceset e ndërhyrjes së jashtëzakonshme.*

Mbrojtjen konsumatore standardi 19 e thekson më qartë në objektivat e përdorimit të këtij mekanizmi, duke kërkuar që legjislacionet të kenë një kuadër të tillë të ndërhyrjes së jashtëzakonshme që:

- *mbrojnë konsumatorin; dhe*
- përcakton që mbulimi i humbjeve të kryhet në mënyrë të tillë që *respekton hierarkinë e pretendimeve në likuidim, hierarki e cila siç u shtjellua në paragrafin e më sipërm preferon konsumatorin.*

Përveç aspektit konceptual, standardi 19 *përmban një zgjerim dhe shtjellim të gjerë të aspekteve procedurale të veprimit të autoritetit rregullator / autoritetit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.* Në konkretizim të konceptit të regjimeve transparente dhe efektive, standardi 19 parashikon kriteret për planifikimin e veprimeve nga autoriteti përkatës, bashkëpunimin dhe bashkërendimin e këtyre veprimeve në autoritete të tjera, kompetencat e autoritetit, elementët e përshkallëzimit të veprimeve, si dhe zgjeron së tepërmi veprimet që kryhen në kuadër të grupeve, degëve, duke përfshirë edhe konceptin e të ashtuquajturit kuadër i përbashkët që vepron në rastin e grupeve të sigurimit që veprojnë aktivisht në skenën ndërkombëtare. Pra, standardi 19 ka një trajtim procedural shumë më të plotë.

III.2. A përmban legjislacioni dispozita, të cilat të trajtojnë aspektin konceptual dhe procedural të ndërhyrjes së jashtëzakonshme në shoqërinë e sigurimit?

Legjislacioni shqiptar në lidhje me falimentimin, kryesisht ligji i sigurimeve, përmbajnë një gamë të ndërhyrjeve duke përmendur transferimin e portofolit, administrimin e përkohshëm, likuidimin (vullnetar dhe të detyruar) apo falimentimin. Gjithashtu, në këtë procedura ka rol autoriteti rregullator, pavarësisht se në shkallë të ndryshme ndërhyrjeje. Megjithatë, legjislacioni nuk i trajton këto elementë në konceptin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, si një proces të organizuar, me

⁵³ Run-off në kontekstin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme është mekanizmi nëpërmjet të cilit, rregullatori i heq të drejtën/autorizimin shoqërisë së sigurimit për të shkruar biznes të ri, ndërkohë që kërkon përmbushjen e të gjitha detyrimeve që burojnë nga kontratat në fuqi.

elementë të planifikimit apo të përshkallëzimit të veprimeve. Mbi të gjitha, legjislacioni shqiptar nuk ka të qartë pikën apo momentin nga e cila bëhet e qartë se veprimet do të duhet të kalojnë në mënyrë të pashmangshme në prishjen e shoqërisë dhe nxjerrjen nga tregu. Pra, legjislacionit i mungon mekanizmi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme, me të gjitha detajet e nevojshme konceptuale dhe procedurale. Gjithashtu, legjislacioni nuk parashikon shprehimisht për AMF-në kompetencat e autoritetit të ndërhyrjes të jashtëzakonshme, si dhe këto kompetenca nuk i vishen as ndonjë autoriteti tjetër në vend.⁵⁴ Për rrjedhojë, **legjislacioni aktual nuk përmbush përcaktimet e ICP 12 në lidhje me ndërhyrjen e jashtëzakonshme**. Kështu në vijim ka kuptim të analizohet legjislacioni në raport veteëm mekanizmat e daljes nga tregu.

III.3. A përmban legjislacioni dispozita, të cilat të trajtojnë mbrojtjen e konsumatorit dhe përparësisë që ka kjo mbrojtje në rastin e situatave të daljes nga tregu të shoqërisë së sigurimit?

Ligji i sigurimeve përcakton që mbrojtja konsumatore ofrohet si qëllim i të njëjtit rang me qëllimin e tregut të sigurt, të qëndrueshëm dhe transparent. Si rregull, në praktikën e tregjeve financiare këto dy qëllime konvergojnë, por nuk është e panatyrshme që këto dy qëllime në situata të caktuara të largohen nga njëri-tjetri, gjë që krijon problemin e përcaktimit të përparësisë së qëllimeve në veprimtarinë mbikëqyrëse dhe rregullatore. Në mungesë të kriterëve të shprehura dhe pa një rast praktik të mëhershëm, përcaktimi i përparësisë do të varet nga interpretimet e rregullatorit ose të gjykatave në rast se çështje të caktuara përfundojnë në gjyqësor.

Nëse për analogji do t'i referoheshim situatës me fondin e kompensimit të trajtuar në disa studime⁵⁵ vërehet që problematika me aftësinë paguese të këtij fondi dhe përmbushjen e detyrimeve ndaj konsumatorit ka çuar në mosrespektim të të drejtave të konsumatorit. Në tërësi, edhe ndryshimet ligjore të propozuara nga rregullatori në vite për legjislacionin që rregullon fushën e sigurimit të detyrueshëm motorik në raportin shoqëri sigurimi – konsumator, kanë preferuar interesat e shoqërisë së sigurimit.

Ndërkohë që me konsumator përcaktohet çdo person që përdor ose përfiton nga shërbimet e ofruara nga siguresi, ose nga shërbimet e ndërmjetësimit (neni 4/20). Pra, titullari i policës, sipas terminologjisë së ICP, është konsumator në konceptin e ligjit të sigurimeve. Ky konsumator, mund të jetë individ ose person juridik, dhe siç është trajtuar në seksionin II, nuk harmonizohet me

⁵⁴ Në legjislacionin shqiptar të fushës financiare kompetencat e ndërhyrjes së jashtëzakonshme për një autoritet nuk mund të nënkuptohen apo të bashkëngjiten. Ato nevojitet të parashikohen shprehimisht. I tillë është rasti i tregut bankar. Banka qendrore e Shqipërisë është njëherësh autoriteti rregullator / mbikëqyrës, si edhe autoriteti i ndërhyrjes së jashtëzakonshme në banka. Por një rol i tillë i është dhënë me ligj të posaçëm (133/2016 “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë”).

⁵⁵ Shih serinë e studimeve të kryera me mbështetjen e rrjetit të avokatëve (OSFA) për trajtimin e konsumatorit në ligjin për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit dhe në administrimin e fondit të kompensimit, 2016-2018.

konceptin e konsumatorit sipas ligjit për mbrojtjen e konsumatorit. Siç do të shihet më poshtë, ky konsumator përfshihet edhe në grupin e kreditorëve të shoqërisë.

Ndërkohë koncepti i trajtimit të konsumatorit është i shpërndarë në dispozita të ndryshme nëpër legjislacion, që mund të analizohen si në vijim:

Në rastin e transferimit të portofoleve, nuk kërkohet miratimi i klientit. Kjo dispozitë në pamje të parë cenon të drejtën konsumatore, sepse pa pëlqimin e klientit kontrata që ai ka përfunduar me një shoqëri sigurimi i kalon një pale tjetër. Gjithsesi këtu mbahet parasysh që në një këndvështrim ky është mekanizëm mbrojtjeje për konsumatorin, pasi bëhet për shkak të vështirësive financiare të shoqërisë transferuese, tek një shoqëri financiarisht e qëndrueshme. Nëpërmjet këtij procesi garantohet vlefshmëria e kontratës dhe ruhet e drejta e dëmshpërblimit në të ardhmen, nga një shoqëri e shëndetshme financiarisht. Por, nëse shoqëria pranuese “shfrytëzon” procesin e transferimit për të rinegociuar terma më diskriminues për klientin kjo çështje nuk është rrjedhojë e drejtpërdrejtë e cenimit të së drejtës së klientit nga transferimi në vetvete por kalon si subjekt i mbrojtjes konsumatore në marrëdhënien me shoqërinë e sigurimit. Megjithatë, legjislacioni nuk shprehet dhe nuk ka të parashikuar mekanizma të qartë veprimi (përmes akteve nënligjore) për të siguruar që të drejtat apo detyrimet e konsumatorit nga transferimi të mos ndryshojnë apo të mos cenohen në mënyrë të qenësishme, duke e vendosur konsumatorin në kushte të pafavorshme.

Në këtë kontekst, ky parashikim vjen përgjithësisht në harmoni me ICP 12 (pjesa e konsumatorit). Por, si mekanizëm mbetet i kushtëzuar nga mundësitë për të gjetur blerës për portofolin.

Mbrojtja e konsumatorit e shprehur si siguri e të siguruarit parashikohet përmes nisjes së procedurës së administrimit të përkohshëm (nenin 161/1/c i ligjit të sigurimeve) kur kjo siguri rrezikohet ose kur cenohet interesi publik (neni 161/2). Megjithatë, këtu jemi në kushtet kur konsumatori mbrohet përpara situatës së falimentimit të një shoqërie sigurimi, gjithsesi me rrezikun e shtjelluar më lart që nuk ka mekanizëm të qartë për mbrojtjen e konsumatorit në transferim.

Në procedurën e likuidimit vullnetar, në funksion të mbrojtjes konsumatorëve një ndër kërkesat për të shqyrtuar vendimin e likuidimit vullnetar është paraqitja e raportit të detajuar në lidhje me trajtimin e kërkesave për dëmshpërblim gjatë likuidimit, të ardhurat dhe shpenzimet, si dhe një parashikim të kohëzgjatjes së procesit, por nuk ka asnjë shprehje për klientët që kanë një policë të cilës nuk i ka përfunduar afati. Ligji, gjithashtu, parashikon disa kritere mbi mbrojtjen e klientit, duke kufizuar vlefshmërinë e licencës, gjë e cila mbron konsumatorin potencial, duke mos e lejuar të konsumojë produkte të një shoqërie në likuidim; si dhe konsumatorin aktual pasi shoqërisë i lejohet kryerja e procedurave të nevojshme për transferimin e portofolit. Megjithatë, nuk parashikohet asnjë formë tjetër mbrojtjeje në rast se nuk përmbushen të tilla rrethana apo për konsumatorin e pashpërblyer pas likuidimit vullnetar të shoqërisë.

E njëjta rrethanë vepron edhe në rastin e procedurave të likuidimit të detyrueshëm. Ligji mbron klientin potencial duke ndaluar lidhjen e kontratave të reja apo ripërtëritjen e atyre ekzistuese; si dhe konsumatorin aktual pasi shoqërisë i lejohet kryerja e procedurave të nevojshme për transferimin e portofolit. Përsëri ligji nuk shprehet për rastet e konsumatorit me një policë të vlefshme dhe kur këto rrethana nuk përmbushen.

Në rastin e likuidimit të detyrueshëm legjislacioni përcakton konceptin e kreditorit të shoqërisë së sigurimit në rolin e tyre në procesin e likuidimit (neni 177), ku parashikohet detyrimi për likuidatorët që të njoftojnë të gjithë kreditorët e njohur të shoqërisë së sigurimit. Neni, gjithashtu, përcakton përmbajtjen e njoftimit, ku përfshihen edhe të drejtat dhe detyrimet e kreditorëve gjatë procesit të likuidimit të detyrueshëm, në veçanti radhën e pagesave të pretendimeve të kreditorëve; si dhe efektet e hapjes së procedurave të likuidimit të detyrueshëm mbi kontratat e sigurimit, në veçanti datën, në të cilën kontratat e sigurimit përfundojnë efektet, dhe të drejtat e detyrimet e personave të siguruar dhe siguruesve në lidhje me kontratën në fjalë. Në kuptim të këtij neni, klienti i shoqërisë së sigurimit është pjesë e kreditorëve, por nuk është i qartë pozicionimi i tij në radhën e preferimit.

Në procedurat e falimentit, si dhe në rastin e likuidimit të detyrueshëm (neni 184) të siguruarit apo përfituesit, sipas kontratave të sigurimit, të nënshkruara nga një shoqëri sigurimi, do të quhen kreditorë dhe pretendimet e tyre kanë përparësi ndaj detyrimeve të tjera të shoqërisë së sigurimit, sipas përparësisë së pretendimeve të klientëve dhe radhës së pagesave të pretenduara (neni 186) si në vijim:

a) pretendimet e kontratave të sigurimit të jetës dhe kontratave të tjera të sigurimit, të cilat janë subjekt i të njëjtave tabela të probabilitetit dhe llogaritjeve si ato të zbatueshme për sigurimin e jetës, të cilat nuk mund të paguhen nga aktivet në mbulim të provigjoneve matematike;

b) pretendimet e kontratave të sigurimit të jojetës dhe kontratave të tjera të sigurimit, për të cilat nuk janë krijuar provigjonet matematike në lidhje me kompensimin e humbjes, të ndodhur përpara hapjes së procedurave të falimentimit, dhe kthimin e një pjese të primit të paguar për periudhën para përfundimit të kësaj kontrate sigurimi;

c) pretendime që rrjedhin nga Byroja Shqiptare e Sigurimeve për pagesat nga fondi i kompensimit, përcaktuar në ligjin nr. 10 076, datë 12.2.2009, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, të ndryshuar, dhe që lidhen me kompensimin e shumës së paguar të dëmeve, për të cilat personat e dëmtuar nuk mund të dëmshpërblehen nga shoqëria e sigurimit për shkak të hapjes së procedurave të falimentimit ndaj kësaj shoqërie.

Pra, legjislacioni përcakton një radhë të përparësisë në ekzekutimin e pretendimeve sipas kontratave, por pa ndarë apo sistemuar pretenduesit ndërmjet tyre (p.sh., individ / tregtar).

Kështu, në thelb orientimet e ICP në lidhje me mbrojtjen e klientit dhe përcaktimin e përparësisë që kanë klientët në procedurën e daljes nga tregu të një shoqërie sigurimi janë të përfshira pjesërisht në legjislacion. Mbi të gjitha mbetet i paqartë raporti i përparësisë së klientit.

III.3.1. Mbrojtja përmes një fondi apo skeme

ICP orienton që në disa juridiksione, ofrohet mbrojtje shtesë ose alternative përmes një fondi apo skeme për mbrojtjen e klientit, të cilat zvogëlojnë nevojën që humbjet të mbulohen edhe nga titullarët e policave. Në rastin e legjislacioni shqiptar ky orientim gjen pasqyrim mjaft të kufizuar. Përveç një mbrojtjeje të përgjithshme që ofrohet nga fondi i garancisë i shoqërive të sigurimit, që gjithsesi në procedura falimenti apo likuidimi ky rol do të varet nga madhësia e këtij fondi në raport me detyrimet, legjislacioni nuk ka të parashikuara mënyra apo fonde të tjera mbrojtjeje të klientit. Kështu, theksohet konkluzioni i paraqitur në seksionin II që legjislacioni nuk ofron mbrojtje klienti pas momentit të falimentimit. Madje, legjislacioni nuk përmban konceptin e skemave të mbrojtjes së klientit, sidomos në rastet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Më të ekspozuar ndaj mungesës së kësaj mbrojtjeje janë klientët e produkteve vullnetare. Klientët e produkteve të sigurimit të detyrueshëm, sipas dispozitave të ligjit për sigurimin e detyrueshëm kanë shanse përfitimi të shlyerjes së detyrimeve përmes fondeve të kartonit jeshi që duhet të krijohen dhe administrohen nga BSHS.

Legjislacioni i sigurimit të detyrueshëm, i cili ka një fushëveprimi më të kufizuar sesa ligji i sigurimeve, ka të parashikuar konceptet dhe procedurat e krijimit dhe administrimit të fondeve.

Kështu, fondi i garancisë së kartonit jeshil në parim ka për qëllim garantimin e detyrimeve financiare, që rrjedhin nga anëtarësimi në sistemin e kartonit jeshil (neni 44 /1) dhe ky fond (neni 44/4) parashikohet të përdoret në rastet e mospërbushjes së detyrimeve financiare të një anëtari të byrosë, përgjegjës për pagesën e dëmshpërblimit, sipas rregullave të sistemit të kartonit jeshil.

Nga pika a e nenit 44 mund të konkludohet që në rastet e daljes nga tregu të një anëtari të byrosë, ky fond shërben si një masë kolektive e përbashkët fondesh për të siguruar dëmshpërblimin e klientëve. Pra, në thelb është një mekanizëm që synon të sigurojë se nuk ndërpritet ofrimi i përfitimeve nga polica për klientët.

Gjithsesi duhet theksuar që për shkak të fushëveprimit të këtij ligji, kjo situatë apo këtë trajtim e marrin një pjesë e konsumatorëve të tregut të sigurimeve, ata që “konsumojnë” kartonin jeshil, dhe jo të gjithë klientët e këtij tregu. Në këtë mënyrë, për shkak të rregullimit ligjor edhe ndërmjet vetë masës së klientëve *a priori* është vendosur një shkallë e ndryshme përparësie.

Ky ligj parashikon që në rast të mbylljes apo falimentimit të shoqërisë së sigurimit, pala e dëmtuar ka të drejtë të paraqesë kërkesën për dëmshpërblim te byroja, dhe ka të drejtën e dëmshpërblimit.

Nga ana tjetër, po në të njëjtën dispozitë parashikohet që: “Në rast të pagesës së dëmeve gjatë kryerjes së procedurave të falimentimit të shoqërisë së sigurimit, byroja ka të drejtë të rimburohet nga shoqëria e sigurimit, që është nën procedurat ligjore, për masën e dëmeve të paguara, shpenzimet dhe interesin e pagueshëm. Për sa kohë zhvillohen procedurat e falimentimit, byrosë i lind e drejta e kompensimit për të gjitha shumat nga gjendja e shoqërisë së sigurimit”. Kështu, klienti për produktet e sigurimit të detyrueshëm motorik nga një pozitë lehtësisht më të favorshme se klienti për sigurimet vullnetare, pasi mund të paraqesë pretendimin tek BSHS. Kjo fundit më pas përfshihet në radhën e kreditorëve të shoqërisë së sigurimit në faliment.

Pra, ligji sigurimit të detyrueshëm e parashikon të drejtën e dëmshpërblimit konsumatorit vendas në rast daljeje nga tregu të një operatori. Por ligji apo aktet nënligjore nuk kanë të përcaktuar mekanizmin e shlyerjes së këtij konsumatori, si dhe mungon një fond i mirëfilltë për këtë qëllim, apo një mekanizëm i qartë financimi. Në praktikë, mungesa e këtyre mekanizmave na risjell pamjen që ndodhi me fondin e kompensimit, ku edhe pse me ligj një fond i tillë duhet të krijohet, në praktikë ky mekanizëm u shpërbë dhe rezultati ishte moskryerje e pagesave të dëmeve për dekada me radhë. Pra, nga ana praktike vetëm parashikimi i të drejtës për dëmshpërblim, qoftë edhe në ligj, nuk mjafton për ta garantuar përfitimin e kësaj të drejte. Nevojitet të ekzistojnë mekanizma dhe procedura të qarta, transparente dhe funksionale për këtë qëllim, në mënyrë që mos të përsëritet situata e fondit të kompensimit.

III.4. A përmban legjislacioni hapa dhe procedura për t’u ndjekur nga autoriteti rregullator përpara se të arrihet në procedurat e daljes nga tregu?

Legjislacioni i sigurimeve (të dyja ligjet bazë) dhe një kuadër i tërë rregullash të miratuara nga AMF përcaktojnë procedura, siç janë nga normat ligjore dhe rregullatore mbi treguesit financiarë dhe mbikëqyrja për të siguruar respektimin e tyre, me qëllim që institucioni të jetë financiarisht i shëndetshëm. Sikurse është theksuar më lart koncepti i aftësisë paguese në rastin e ligjit të sigurimeve aplikohet me synim parandalues për falimentimin dhe përfundimin e shoqërisë së sigurimit. Në funksion të këtij koncepti, legjislacioni parashikon masa mbikëqyrëse dhe administrative që ndërmerren për të kërkuar respektim të normave në rast shmangieje prej tyre. Këto procedura janë të shprehura në standardet e raportimit dhe të mbikëqyrjes, dhe si rregull duhet të ndiqen deri në momentin përfundimtar, që është tërheqja e licencës së shoqërisë së sigurimit. Nëse këto procedura i përkasin përditshmërisë së veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit dhe të autoritetit mbikëqyrës, disa procedura janë më të rralla dhe që funksionojnë si mekanizma që autoriteti mbikëqyrës i vë në përdorim pa u arritur faza e daljes nga tregu.

Një mekanizëm i tillë është transferimi tërësor apo pjesor i portofolit të sigurimit (pra i kontratave të sigurimit) nga një shoqëri sigurimi (shoqëria transferuese) tek një tjetër shoqëri sigurimi (shoqëria pranuese). Ligji për sigurimet (seksioni IV, nenet 45-47) lejon transferimin e portofolit duke kërkuar që:

- transferimi të bëhet nëpërmjet një marrëveshjeje ndërmjet dy shoqërive;
- transferimi të bëhet me të gjitha të drejtat dhe detyrimet;
- transferimi të bëhet nëse shoqëria pranuese ka nivelin e kërkuar të aftësisë paguese, me qëllim që procesi të mos diktojë cenim të shëndetit financiar të një tjetër subjekti;
- transferimi të përfshijë edhe aktivet në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike për të mbuluar përgjegjësitë e protofolit të transferuar;
- transferimi të bëhet me miratim të Autoritetit;
- transferimi të bëhet sipas disa procedurave dhe afateve strikte;
- transferimi të mos ketë nevojë për miratimin e klientëve (siguruarve) por këta të njoftohen brenda afatit ligjor nga shoqëria pranuese.

Siç do të shihet më pas, transferimi i portofolit është një veprimtari që i lejohet shoqërisë së sigurimit në situatat e administrimit të përkohshëm, të likuidimit vullnetar apo të detyrueshëm, si edhe në situatën e falimentimit.

Gjithashtu, ligji për sigurimet parashikon që procesi i transferimit mund të mos miratohet kur ekzistojnë kushtet sipas të cilave:

- shoqëria pranuese nuk plotëson kërkesat ligjore apo nuk është e licencuar për klasat e sigurimeve që i përkasin portofolit që transferohet;
- veprimtaria e shoqërisë pranuese në lidhje me rregullat e administrimit të rrezikut, mund të përkeqësohet;
- vlera e aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike e shoqërisë pranuese është më e ulët sesa vlera e provigjoneve që duhet të krijoheshin përkundrejt portofolit të sigurimit që do të transferohet.

Këto kritere mbi të cilat refuzohet transferimi i portofolit, janë një tjetër instrument apo procedurë që parashikon legjislacioni si masë veprimi për të mos lejuar përkeqësimin e situatës financiare apo të administrimit të rrezikut në shoqërinë e sigurimit, gjë që mund të çojë edhe në cenim të raportit me konsumatorin.

Megjithatë, ligji nuk përcakton qartë shkaqet mbi bazën e të cilave nxitet procesi i transferimit të portofolit, kur nuk jemi në kushtet e likuidimit apo të falimentimit, pra që është arritur në këtë fazë. E shprehur ndryshe, meqenëse kemi të bëjmë me marrëdhënie ndërmjet dy personave juridik, atëherë qartazi transferimi i portofolit do të mund të përfundohet vetëm me vullnetin e dy palëve. Autoriteti mbikëqyrës nuk ka mekanizma plotësues të një mase të tillë apo procedura të detajuara për zbatimin e këtij instrumenti, me qëllim mbrojtjen e klientit, në rast se shoqëria po përballet me probleme serioze financiare dhe është në prag likuidimi. Për rrjedhojë, ky mekanizëm në praktikë, megjithëse mund të jetë një zgjidhje optimale, mund të rezultojë i papërdorshëm për të shmangur daljen nga tregu të një shoqërie sigurimi. E theksojmë që i gjithë kuadri i ndërhyrjes së jashtëzakonshme si një proces i organizuar mungon në legjislacion.

Pra, në konceptin e ICP legjislacioni ka të përcaktuar qartë organizmin përgjegjës që miraton ose jo procesin e transferimi të portofolit, dhe mund ndikojë në kryerjen e këtij transferimi nga momenti kur shoqëria e sigurimit ka hyrë në procedurat e administrimit të përkohshëm dhe përshkallëzimin e tyre në likuidim apo falimentim.

Ndërkohë edhe bashkimi apo shkrirja e shoqërive sipas legjislacionit bëhet me miratimin e Autoritetit, po nuk ka ndonjë përcaktim mbi mundësinë e përdorimit të këtij mjei nga Autoriteti përpara se të kalohet në faliment. Për rrjedhojë, në këtë aspekt përsëri ofrohet një përmbushje e pjesshme e orientimit të ICP-së.

III.5. A trajton legjislacioni paaftësinë paguese?

Aftësia paguese është një ndër kriteret bazë, por jo i vetmi, për të vlerësuar shëndetin financiar të një shoqërie sigurimi. Por aftësia paguese në konceptin e ligjit të sigurimeve vendoset dhe ndiqet me synim parandalimin e daljes nga tregu të shoqërisë së sigurimit. Mosrespektimi i treguesit të aftësisë paguese, të shprehur me anë të mjaftueshmërisë së kapitalit, tregon edhe përkeqësimin që po pëson shëndeti financiar i një shoqërisë sigurimi, shpejtësisë së përkeqësimit dhe nëse po shkohet drejt fazës kur shoqëria duhet të dalë nga tregu.

Për rrjedhojë, ligji i sigurimeve ka të parashikuara konceptet dhe procedurat që lidhen me aftësinë paguese, si dhe masat që nevojitet të merren që shoqëria e sigurimit të rimëkëmbet nga ana financiare, duke iu larguar vendimit të daljes nga tregu. Duke u nisur nga koncepti parandalues, ligji (neni 150) i ngarkon AMF-së marrjen e masave mbikëqyrëse për rastet e:

- paaftësisë së përmbushjes së detyrimeve në afat nga shoqëria e sigurimit apo kërkesat për mjaftueshmërinë e kapitalit ose fondin e garancisë;
- pamjaftueshmërisë së aktiveve të shoqërisë që të grantohet mbrojtje e përshtatshme për të siguruarit dhe kreditorët;
- rrezikimit të interesat e të siguarve dhe/ose niveli i kapitalit nuk është i mjaftueshëm apo po zvogëlohet në mënyrë të tillë që mund të ndikojë negativisht ndaj të siguarve apo kreditorëve;
- kryerjes së veprimeve që përbën praktikë të rrezikshme apo të paqëndrueshme për veprimtarinë e shoqërisë
- dëmtimit të interesat të siguarve, kreditorëve apo zotëruesve të aktiveve nën administrimin e shoqërisë, duke përfshirë këtu edhe rastin e hapjes së procedurave të falimentimit në Shqipëri, apo diku tjetër, në rast kur kemi të bëjmë me grup.

Pra, sipas legjislacionit, mos respektimi i aftësisë paguese (kalimi në situatën e paaftësisë paguese) përshkallëzon masat mbikëqyrëse, si formë e trajtimit të paaftësisë paguese sipas orientimit të ICP-së.

III.6. A trajton legjislacioni një gamë mundësish për daljen nga tregu të shoqërive të sigurimit?

Legjislacioni në fuqi ofron format tradicionale të likuidimit (vullnetar ose të detyrueshëm) apo të falimentimit. Legjislacioni ofron edhe mjetin e administrimit të përkohshëm, por produkti i këtij mjeti jo gjithmonë mund të çojë në dalje nga tregu, madje qëllimi i administrimit të përkohshëm shihet si masë që të shmangë daljen nga tregu të shoqërisë dhe rikthimin e shoqërisë së sigurimit si një institucion i shëndetshëm. Prandaj, ky mjet do të trajtohet në raport për aq sa i ai lidhet me procesin e falimentimit.

Legjislacioni përcakton një gamë mundësish për daljen nga tregu të personave juridikë të fushës së sigurimeve (shoqëri sigurimi).

III.6.1. Administrimi i përkohshëm

Administrimi i përkohshëm në konceptin e ligjit përshkallëzohet në vijim të masave të mbikëqyrjes (neni 161) dhe lidhet me kushtin e mosarritjes së nivelit të kërkuar të aftësisë pagueuse. Por, pavarësisht qëllimit të shprehur në ligj për marrjen e masës së administrimit të përkohshëm, jo gjithnjë është e mundur që shoqëria e sigurimit të shpëtohet. Momenti i përcaktimit nëse shoqëria do të rikthehet si operator i shëndetshëm në treg apo do të shkojë drejt daljes nga tregu nuk është përcaktuar qartë në legjislacion, por i lihet si detyrë administratorit të përkohshëm (neni 166/3) që brenda 9 muajve nga data e emërimit, të depozitojë në Autoritet një raport mbi gjendjen financiare dhe ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit, në kushtet e administrimit të përkohshëm, së bashku me një vlerësim të qëndrueshmërisë dhe mundësive për vazhdimësinë ose jo të veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit. Ky raport përfshin, ndërmjet të tjerash edhe vlerësimin e kushteve për likuidim apo falimentim të shoqërisë së sigurimit.

Por ligji sqaron që (neni 167/3) administratori sipas urdhrave nga Autoriteti vë në dijeni asamblenë e përgjithshme të aksionarëve që, në rast se refuzohet rritja e kapitalit, shoqëria e sigurimit do të kalojë në falimentim. Në këtë mënyrë ligji qarëson vetëm një kriter të kalimit në faliment, rastin kur asambleja aksionarëve refuzon rritjen e kapitalit, pra kur shoqëria është në kushtet e paaftësisë pagueuse.

Gjithashtu ligji parashikon dhe një moment të dytë për përfundimin e shoqërisë së sigurimit sipas nenit 168 /5, rastin kur Autoriteti nuk merr vendim për zgjatjen e administrimit të përkohshëm, atëherë vendos për revokimin e licencës për të ushtruar veprimtari sigurimi.

III.6.2. Likuidimi vullnetar

Likuidimi vullnetar, parashikohet të kryhet sipas dispozitave të ligjit të sigurimeve dhe ligjit të shoqërive tregtare. Këtu thelbi qëndron në faktin që likuidimi vullnetar nuk mund të kryhet pa

miratim të shprehur të autoritetit, përdryshe përbën një akt të pavlefshëm juridikisht, pra përcakton prevalencë të ligjit të fushës ndaj ligjit të shoqërive tregtare.

III.6.3. Likuidimi i detyrueshëm

Procedura e likuidimit të detyrueshëm nisët nga Autoriteti sipas rasteve të përcaktuara në nenin 175 të ligjit:

- është revokuar licenca për kryerjen e veprimtarisë së sigurimit;
- vlerësohet se gjatë periudhës së administrimit të përkohshëm gjendja financiare e shoqërisë nuk përmirësohet në atë masë që shoqëria e sigurimit të arrijë nivelin e aftësisë paguese;
- mbledhja e asamblesë së përgjithshme e shoqërisë së sigurimit, nuk miraton vendimin për rritjen e kapitalit të shoqërisë së sigurimit ose e miraton atë, por dështon shitja e parë e aksioneve.

Por nuk përcaktohet nëse ka të drejtë apo jo nëse likuidimi me detyrim mund të nisë me kërkesë të kreditorit. Edhe likuidimi i detyrueshëm trajtohet në të njëjtat raporte si likuidimi vullnetar përsa i përket ndërveprimit të ligjit të fushës me ligjin për shoqëritë tregtare.

III.6.4. Falimentimi

Përsa i përket procedurës së falimentimit, legjislacioni përcakton rastet e propozimit të hapjes së procedurave (neni 183) nga Autoriteti:

- nëse vlerëson se gjendja financiare e shoqërisë së sigurimit nuk është përmirësuar gjatë administrimit të përkohshëm dhe nëse shoqëria e sigurimit nuk është në gjendje të përmbushë përgjegjësitë e saj aktuale;
- nëse edhe pas marrjes së masave të mbikëqyrjes konstatohet se aktivet e saj janë të pamjaftueshme për të përmbushur detyrimet e kreditorëve;
- nëse shoqëria e sigurimit ndodhet në gjendjen e mbingarkesës me borxhe dhe, për pasojë, nuk ka mundësi të vazhdojë veprimtarinë e të përmbushë detyrimet e kreditorëve kur u vjen afati;
- nëse asambleja e përgjithshme e aksionarëve refuzon propozimin për rritjen e kapitalit;
- nëse gjatë ushtrimit të mbikëqyrjes së shoqërisë së sigurimit konstaton ndonjë rast tjetër të falimentimit, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Për pjesën tjetër të rregullimit të nevojshëm të një procedure falimenti, neni 182 i ligjit konsideron si dispozita të zbatueshme parashikimet e ligji nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar, kontradiktë e cila është shtjelluar gjerësisht në seksionin II të këtij raporti.

III.7. A parashikon legjislacioni bashkëpunimin dhe bashkërendimin me rregullatorë të tjerë?

Meqenëse në konfigurimet e sotme të veprimtarive financiare, shoqëritë e sigurimit mund të jenë pjesë e grupeve financiare se jo, por edhe mund të kryejnë veprimtari përtej kufijve me anë të degëve, filialeve etj., standardet e mbikëqyrjes orientojnë për bashkëveprim ndërmjet autoriteteve rregullatore përkatëse. Të tilla bashkëveprime rregullohen me marrëveshje të posaçme, të cilat janë ose jo publike.

Në konceptin e ICP 12 (standardi 19) theksohet në mënyrë të zgjeruar ky ndërveprim, sidomos në rastin e grupeve të shoqërive të sigurimit që kanë peshë në tregun global. Legjislacioni shqiptar gjithashtu parashikon të tilla ndërveprime. Kështu, e gjithë procedura e likuidimit, si vullnetar dhe të detyrueshëm, kërkon edhe njoftimin paraprakisht të autoritetit kompetent mbikëqyrës të vendit anëtar në rast se i referohet një shoqërie sigurimi me degë në një vend anëtar. Por, për mbrojtjen e interesave të konsumatorit apo të interesave publikë njoftimi mund të kryhet edhe pas marrjes së vendimit (neni 171). Gjithsesi nuk ka ndonjë trajtim të posaçëm për shoqërinë e sigurimit si pjesëtare grupi.

Orientimi i ICP-së për sigurimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit në rastet kur një shoqëri sigurimi ka aktivitet përtej kufijve, gjithashtu, përcaktohet edhe në legjislacionin shiptar dhe modalitetet e bashkëpunimit detajohen përmes marrëveshjesh një apo shumëpalëshe. Në parim pritjet që i njëjti rregull të veprojnë edhe për rastin kur shoqëria e sigurimit është pjesë e grupit, por legjislacioni nuk e parashikon shprehimisht, duke siguruar kështu përmbushje të pjesshme të orientimeve për bashkëveprim me rregullatorë të tjerë.

Megjithatë, ky vlerësim mbetet deri diku i cunguar në mungesë të analizës së marrëveshjeve me rregullatorët e tjerë dhe efektivitetit të zbatimit të tyre në praktikë.

* * *

*

Në tërësi, **konkludohet** që legjislacioni shqiptar ka një përputhje të pjesshme me ICP 12 në lidhje me përcaktimet për daljen nga tregu të shoqërisë, duke patur nevoja për përcaktime më të qarta në sanksionimin e së mbrojtjes së konsumatorit, plotësimin të kuadrit rregullator me aspektet proceduriale të trajtimit të daljes nga tregu të një shoqërie sigurimi dhe veçanërisht plotësimin të legjislacionit me mekanizmin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

IV. “FATURA” E FALIMENTIT

Në tregun e sigurimeve të Jo-jetës në Shqipëri ushtrojnë veprimtarinë tetë shoqëri sigurimi. Primet e shkruara bruto në tregun e sigurimeve të jo-jetës kapën nivelin prej 16.3 mld lekë, vëllim i cili përkthehet në 1.2 milionë kontrata për vitin 2019, sipas shifrave të publikuara në faqen zyrtare të AMF⁵⁶. Pavarësisht dominimit të sigurimit të detyrueshëm motorik, i cili përbën dhe afro 69% të tregut të jo-jetës, ekspozimi përtej sigurimit të detyrueshëm motorik është i konsiderueshëm, sidomos në sigurimin e pronës apo sigurimet e bizneseve. Konkretisht, të gjitha bizneset kredimarrëse janë të detyruara të sigurojnë pronat dhe rreziqet që lidhen me aktivitetin e tyre, si kërkesë e bankave të nivelit të dytë. Në këtë mënyrë, ka një ekspozim të konsiderueshëm dhe të tregut bankar ndaj tregut të sigurimeve, si për individët ashtu dhe për bizneset kredimarrëse. Në këtë kontekst, falimentimi i një shoqërie me pjesëmarrje të konsiderueshme në treg, do të linte një faturë të konsiderueshme jo vetëm për konsumatorët apo individët, që presin dëmshpërblim nga sigurimi i detyrueshëm motorik, por dhe për konsumatorët e sigurimeve vullnetare. Për këta të fundit, siç është analizuar në këtë punim, nuk ka mekanizëm ligjor financimi, që do të thotë, nëse Autoriteti rregullator vepron jo në kohën e duhur me masat mbikëqyrëse, praktikisht kjo faturë rëndon direkt mbi individët dhe bizneset.

Në tërësi, dalja nga tregu e një shoqërie me pjesëmarrje të konsiderueshme në treg do të shkaktonte një faturë jo të vogël për individët dhe bizneset. Mjafton t’i referohemi ngjarjes së fundit, si tërmeti i 26 nëntorit 2019, për të vlerësuar ndikimin e rëndësishëm që tregu i sigurimeve ka në ekonominë familjare dhe në gjithë sistemin financiar në Shqipëri.

Siç është shpjeguar dhe në seksionin III, legjislacioni i sigurimeve krijon mekanizma të pjesshëm mbrojtjeje për konsumatorët, vetëm në rastin e sigurimit të detyrueshëm motorik. Për të përcaktuar me përafërsi, sa mund të jetë fatura e mundshme e një falimenti në tregun e sigurimeve të jo-jetës, i jemi referuar shifrave të publikuara në faqen zyrtare të internetit të AMF. Për të bërë një vlerësim të saktë, nevojiten shifra të detajuara dhe baza të dhënash mbi ekspozimet individuale të çdo subjekti, të cilat praktikisht janë të dhëna tregtare që nuk janë publike.

Për këtë arsye, kemi marrë si shembull hipotetik daljen nga tregu të një kompanie ose grupi me pjesëmarrje të konsiderueshme në treg, me kushtin që nuk përmbush treguesit ligjorë sipas përcaktimeve të AMF. Me tregues ligjorë nënkuptojmë mjaftueshmërinë e kapitalit. Nga të dhënat e publikuara nga AMF, kemi përzgjedhur shoqërinë me pjesëmarrje më të madhe në treg, e cila nuk përmbush treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit. Arsyeja për këtë përzgjedhje është masa e ndikimit në gjithë tregun, kundrejt një shoqërie të vogël, e cila nuk ka të njëjtin ndikim. Gjithashtu, në këtë analizë nuk kemi marrë parasysh aktivitetin jashtë territorit⁵⁷, pra ndikimin në nivel grupi

⁵⁶ <https://amf.gov.al/statistika.asp?id=1&s=1&r=1>.

⁵⁷ Me aktivitet jashë territorit kryesisht i referohemi aktivitetit në Kosovë dhe Maqedoni. Ekspozimi kryesor në tregun shqiptar të sigurimeve vjen nga Kosova, ku shoqëritë shqiptare të sigurimit ushtrojnë veprimtari në formën e degës,

përtej kufijve, duke e kufizuar ndikimin deri në kufirin e provigjoneve të dëmeve në tregun vendas. Në këto kushte ky është skenari më optimist, pasi në realitet ndikimi është shumë më i lartë. Kjo për faktin, se kur kemi të bëjmë me struktura grupi, të cilat ushtrojnë veprimtari dhe si degë jashtë territorit, fatura e falimentit rritet dhe me detyrimet apo përgjegjësitë që ato kanë, në juridiksionet ku ushtrojnë veprimtari.

Këtu rasti konkret është juridiksioni i Kosovës, ku shumica e shoqërive shqiptare veprojnë si degë dhe jo si filiale. Kohët e fundit, një prej degëve të shoqërive shqiptare është mbyllur nga Banka Qendrore e Kosovës, duke krijuar pasiguri se sa do të jetë fatura për tregun shqiptar të sigurimeve. Në këto kushte, skenari i përzgjedhur është konkret dhe vlen të analizohet për të parë se sa të mjaftueshme janë kuadri ligjor dhe mekanizmat e ndërtuar nga AMF për të përballuar këtë goditje të mundshme.

Edhe pse legjislacioni i sigurimeve nuk ka mekanizëm financimi për trajtimin e dëmeve të sigurimit vullnetar pas daljes nga tregu të një siguruasi, për qëllime të këtij studimi, faturë do të quajmë atë element që prek direkt konsumatorin, i cili mbetet pa dëmshpërblim. Siç e theksuam më sipër, skenari i ilustruar, është skenari më optimist, pasi i kemi referuar vetëm rezervës së dëmit, të njohur dhe bërë publike në faqen zyrtare të AMF.

Nëse do të kryenim rregullime të mëtejshme për të vlerësuar nivelin e mundshëm të nënprovigjoneve, të cilat janë më se të zakonshme në tregjet në zhvillim, apo dhe dinamikën e zhvillimit të dëmeve, fatura do të rezultonte shumë më e lartë.

Për skenarin e përzgjedhur, kemi supozuar daljen nga tregu të një kompanie apo grupi, bazuar mbi kriteret e mëposhtme:

1. **Madhësia në treg.** Kjo nënkupton një pjesëmarrje në treg të paktën 15% në nivel primi, ose më tepër në nivel grupi kompanish të lidhura;
2. **Probleme me treguesit ligjorë,** sipas publikimeve të AMF. Ky kusht është përzgjedhur për ta bërë sa më të prekshëm skenarin, pasi mundësia për dalje nga tregu është e mundshme në një periudhë afat-shkurtër ose afat-mesme, në varësi të forcës së AMF për të imponuar zbatimin e ligjit;

ku përgjegjësia për mbështjeten e gjithë detyrimeve me kapital është përgjegjësi e shoqërisë mëmë, e cila është e vendosur në Shqipëri.

3. **Grupi i kompanive që plotëson kriteret më sipër ka prezencë të konsiderueshme dhe në rajon,** duke rritur ndjeshëm mundësinë e rritjes disa herë të faturës së përlogatur për tregun vendas, sidomos në juridiksionin e Kosovës, ku veprimtaria ushtrohet si degë, që nënkupton, shoqëria mëmë dhe juridiksioni ku mëma është e vendosur ka përgjegjësinë për përballimin e faturës.

Skenari i zgjedhur është skenari më optimist për arsyet më poshtë:

1. Në tregjet në zhvillim ka gjithmonë element nënprovigjoni, pra në realitet provigjonet mund të jenë më të larta se ato që publikohen;
2. Në këtë analizë kemi marrë në konsideratë vetëm provigjonin e dëmit, i cili dominohet kryesisht nga provigjoni i sigurimit të detyrueshëm motorik. Në këto pasqyra nuk është reflektuar ende situata me tërmetin e nëntorit 2019;
3. Për mungesë të shifrave është e pamundur të përlogaritët sa është ekspozimi ndaj sistemit bankar për sigurimin e kolateralit si të individëve dhe biznesit, që për rrjedhojë në rastet e vështirësive financiare apo gjatë një procesi likuidimi e bën të pamundur transferimin e këtij portofoli, nëse nuk mbështetet me aktivet në mbulim të këtyre përgjegjësive. Në këto rrethana portofoli pritet të maturohet, ndërkohë që nuk ka procedura dhe mekanizma të qartë mbrojtës për publikun e siguruar, përveç disa dispozitave në legjislacionin e sigurimeve;
4. Mungesa e përvojës me raste të ngjashme dhe eksperiencia e tregjeve të tjera në zhvillim, ka treguar që në raste daljesh nga tregu, niveli i aktiveve që mbështetin detyrimet, praktikisht i afrohet nivelit zero. Në rastin e Shqipërisë e kemi supozuar që fondi i garancisë prej 370 mln lekë do të jetë i disponueshëm për të zbutur faturën;

Ndikimi në treg në rast të daljes së një operatori me pjesëmarrje të konsiderueshme është mjaftueshëm i rëndë. Praktikisht, nga vlerësimet që kryhet mbi bazën e kufizimeve të shtjelluara më lart, gërryhet minimalisht 45% e kapitalit të tregut të jo-jetës. Kjo i çon automatikisht të gjitha kompanitë, pa përjashtim, në paaftësi paguese, në raport me minimumin ligjor për të vijuar aktivitetin e tyre.

Në tabelën më poshtë po japim një ilustrim të disa prej këtyre treguesve dhe si ata evoluojnë pas ndikimit nga ky skenar:

Tabelë 2: Ilustrim me anë të treguesve tekniko-financiarë të faturës së falimentimit (mln lekë)

Treguesi	Albsig	Ansigt	Atlantik	Eurosig	Insigt Jo-Jetë	Intersigt	Sigtal	Sigmat	Tregu jo-jetës total
Kapitali minimal ligjor i kërkuar	473	370	370	575	370	370	740	370	3,638
Primet e Shkruara Bruto	1,953	992	882	2,271	1,086	1,667	4,003	2,139	14,993
Pjesëmarrja në treg	13%	6%	5.9%	15.15%	7.24%	11.12%	26.70%	14.27%	100%
Aftësia paguese para skenarit	716	265	693	(1,744) ⁵⁸	(1,681)	474	967	564	3,679⁵⁹
Provizjonet teknike bruto	1,660	720	596	1,742	1,459	1,663	4,284	2,540	14,138
Provizjonet e dëmeve bruto	563	234	168	730	949	887	2,292	1,488	7,311
Impakti ⁶⁰	280	280	280	n/a	n/a	280	280	280	1,679
Aftësia paguese pas skenarit	436	-15	413	n/a	n/a	194	687	284	2,000

Tabela e mësipërme reflekton situatën më optimiste, pasi bazohet mbi rezultatet e publikuara nga vetë shoqëritë, ku në realitet situata mund të jetë e ndryshme. Këtu nuk është reflektuar fatura e pritshme të tregut të 26 nëntorit 2019. Kjo faturë nënkupton një rritje të konsiderueshme (mbi trendin normal) të kërkesave për dëmshpërblim kryesisht nga produkti i pronave. Meqenëse ngjarja e tregut la pasojë kryesisht në zonën e Durrësit dhe të Tiranës, me qytetet më të afërta, kjo e rrit edhe më tej pretendimin për dëmshpërblim, duke qenë se në këto zona ka përqendrim pronash dhe aktiviteti huadhënës nga bankat në favor të të cilave janë siguruar këto prona. Kërkesa e shtuar për dëmshpërblim, pra për pagesa dëmsh, ndikon në likuiditetin dhe parametrat financiarë të tregut, sidomos në kushtet nëse ky portofol i sigurimit të pronës është i përqendruar dhe jo i shpërndarë ndërmjet operatorëve të tregut.

Gjithashtu, në informacionet e publikuara nga autoriteti rregullator të treguesve financiarë për çdo shoqëri në treg, mungojnë të dhënat për një shoqëri, e cila ka mbi 15% të tregut. Pavarësisht se bëhet fjalë për publikimin e detyrueshëm të treguesve sipas rregulloreve të Autoritetit dhe në zbatim të kërkesës së Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, kjo kërkesë nga viti 2018 nuk zbatohet

⁵⁸ Referuar Raportit të Mbikëqyrjes AMF 2017.

<https://amf.gov.al/pdf/publikime2/mbikeqyrje/RaportiMbikeqyrjes2017.pdf>. Janë përdorur të dhënat e vitit 2017 pasi janë të fundit që përmbajnë informacion për të gjitha shoqëritë në treg. Në vitin 2018 raporti i AMF nuk përfshin më të gjitha shoqëritë.

⁵⁹ Pa efektin e dy shoqërive të grupit, që kanë aftësi paguese negative.

⁶⁰ Në mungesë të një mekanizmi shpërndarjeje, është bërë një ndarje e barabartë e faturës tek operatorët e tjerë të tregut.

njëtrajtësisht për të gjithë operatorët në tregun e sigurimeve. Në këto kushte, për vlerësimet detyrohemi t'i referohemi raportit të mbikëqyrjes 2017, të publikuar nga AMF, ku në faqen 59 paaftësia paguese e kombinuar e dy shoqërive të grupit është afro 3.8 miliardë lekë, ndërkohë që i gjithë tregu mbulon vetëm 28% të kërkesës për kapital⁶¹. Thënë ndryshe, në situatën aktuale në të cilën tregu ndodhet, nëse tregu do të konsiderohej si një shoqëri e vetme, do të konsiderohej në paaftësi paguese ose praktikisht i falimentuar.

Në këto rrethana kemi tre skenarë, të cilët mund t'i konsiderojmë si kosto e falimentit:

1. Vlera prej **3.8 mld lekë**, e cila përfaqëson mungesën e kapitalit nga dy shoqëritë e grupit vendas, të cilat bashkërisht përfaqësojnë 22% të tregut vendas, por që kanë gërryer 73% të gjithë kapitalit të tregut të jo-jetës;
2. Vlera prej **1.7 mld lekë**, që përfaqëson provigjonin e dëmeve të dy shoqërive të grupit. Këtu për të zbutur sadopak efektet e nënprovigjonimeve të mundshme, nuk do të konsiderohet efekti zbutës i fondit të garancisë. Efekti i nënprovigjonimit mund të jetë serioz, pasi mjafton të analizojmë shifrat në tabelën e mësipërme, ku rezulton që shoqëri me të njëjtën pjesëmarrje në treg kanë gati dy herë më të larta provigjonin e dëmeve;
3. Vlera prej **2.3 mld lekë**, që përfaqëson provigjonin total të dy shoqërive në fjalë, pjesë e të njëjtit grup, reduktuar me masën e fondit të garancisë.

Mjafton vetëm ky ushtrim i thjeshtë, të konstatojmë, që ndikimi është serioz dhe sistemik, edhe nëse përzgjidhet fatura më e ulët, ajo prej 1.7 mld lekë. Edhe në këtë rast përballemi praktikisht me dështimin e një segmenti të tërë tregu, konkretisht sigurimit të jo-jetës. Fondi i kompensimit pati një faturë edhe më të ulët dhe dëmet vijuan të zvarriten me dekada, ku ende sot nuk është e qartë, nëse janë shlyer apo jo. Pra e gjithë kjo faturë, do të akumulohet bashkë me pjesën e mbetur të fondit të kompensimit, duke krijuar një situatë praktikisht të pamundur për tu administruar nga aktorët e tregut, pasi fuqia absorbuese dhe mekanizmat e administrimit të kësaj situatë mungojnë.

* *

*

Duke konkluduar, dalja nga tregu e një shoqërie jo-jete ose grupi, do të rezultonte në një kosto minimalisht në vlerën 1.7 mld lekë, duke shkaktuar paaftësi paguese tek pothuajse të gjithë aktorët e tregut, si dhe ngërç serioz likuiditeti. Pra, rreziku është i pranishëm dhe duhet administruar me prioritet nga politikbërësit.

⁶¹ <https://amf.gov.al/pdf/publikime2/mbikeqyrje/RaportiMbikeqyrjes2017.pdf>

V. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Ky raport i organizuar sipas një strukture që fillon me analizën e legjislacionit vendas, vijon me analizën ballafaqese me standardin ndërkombëtar dhe përfundon me analizën e faturës së falimentimit, synon identifikimin e problemeve që ka rregullimi ligjor me pasoja në mbrojtjen e konsumatorit, në procesin e trajtimit të një shoqërie sigurimi në vështirësi financiare. Nga kjo analizë arrihet në disa përfundime:

- Legjislacioni në fuqi ka mangësi dhe parashikime kontradiktore në trajtimin e procesit dhe procedurës së falimentimit të një shoqërie sigurimi. Referimi me ligjin për falimentimin është i pasaktë, pasi ligji është i shfuqizuar. Ndërkohë ligji për falimentimin përjashton shoqëritë e sigurimit. Në këto kushte të vetmet dispozita që rregullojnë procesin e falimentimit janë ato të ligjit të fushës. Siç u trajtua në këtë punim, ligji i fushës nuk trajton të plota aspektet e falimentimit. Mungesa e dispozitave krijon ngërç për konsumatorët dhe krijon rrezik për administrimin efektiv të procesit të falimentimit. Këto mangësi dhe kundërshti e bëjnë të paqartë procedurën në praktikë të daljes nga tregu të shoqërisë së sigurimit dhe rrjedhimisht edhe të përmbushjes së detyrimeve ndaj konsumatorëve, veçanërisht të pagesave të dëmshpërblimeve. Praktikisht, një shoqëri sigurimi në rrethanat aktuale është ‘e paprekshme’, pasi nuk ka mekanizëm ligjor për dalje nga tregu.
- Legjislacioni nuk është i konsoliduar në përcaktimin e konsumatorit në tregun e sigurimeve. Konsumatori vulnerabël është i paidentifikueshëm veçmas midis kreditorëve të njohur të shoqërisë së sigurimit. Kjo sjell drejtpërsëdrejti pasoja në trajtimin e shpejtë dhe efikas të konsumatorit vulnerabël në kushtet e paafësisë paguese të shoqërisë së sigurimit.
- Dalja e një ose disa shoqërive nga tregu është një skenar tepër i mundshëm, po t’i referohemi publikimeve zyrtare të AMF-së. Fatura e një daljeje të mundshme mund të variojë nga 1.7 deri në 3.8 miliardë lekë. Praktikisht një ngjarje e tillë, do ta vendoste tregun e sigurimeve të jo-jetës në pamjaftueshmëri të theksuar kapitali dhe probleme serioze likuiditeti. Mund të konkludojmë që ky skenar i mundshëm ka pasoja sistemike për tregun e sigurimit të jo-jetës.
- Legjislacioni nuk parashikon skema për mbrojtjen e konsumatorit dhe veçanërisht në momentin e pas falimentit nuk ka mekanizma për mbrojtjen e tij.
- Legjislacioni trajton jo në mënyrë të njëjtë konsumatorin e tregut të sigurimeve. Ligjërisht, të vetmit konsumatorë që mund të përfitojnë dëmshpërblim pas daljes nga tregu të një shoqërie sigurimi, janë përfituesit e policave të sigurimit të detyrueshëm, objekt i ligjit të sigurimit të detyrueshëm në fushën e transportit. Ky ligj ngarkon operatorët e mbetur në treg për të pëballuar detyrimet për dëmet e papaguara të një operatori që del nga tregu, por nuk ka të zhvilluara mekanizma plotësues apo skemë të qartë financimi. Në këto rrethana, ka rrezik të ndodhë e njëjta situatë si me fondin e kompensimit, ku dëmet e papaguara vijuan të mbeten pezull për dekada. Ndërsa konsumatorët e produkteve të detyrueshme

kanë një mundësi për mbrojtje, ata të produkteve vullnetare janë praktikisht të pambrojtur me ligj.

- Legjislacioni nuk trajton aspektet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme në treg, si mekanizëm që drejton një proces të organizuar. Legjislacioni i sigurimeve ka vetëm disa mekanizma bazë, që mund të përdoren gjatë procesit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, si likuidimi apo transferimi i portofolit. Por këto mekanizma nuk janë të detajuara apo të mbështetura proceduralisht me akte nënligjore të detajuara për zbatimin e tyre. Gjithashtu, ka një mungesë të një sërë mekanizmave, të cilat kombinohen në rastet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, si *run-off*, ndarja e aktiveve dhe detyrimeve, vendosja e kufizimeve për përfundimin e kontratave, apo dhe deri tek mungesa e një mekanizmi të qartë financimi. Mungesa e këtyre instrumentave kufizon rrezën e veprimit të autoritetit rregullator dhe kthehet në potencial për rritje kostosh të procesit, i cili shkon drejtpërdrejt në kurriz të konsumatorëve.
- Legjislacioni nuk ka të parashkuar autoritetin përgjegjës për vënien në funksion të mekanizmit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.
- Nga pikëpamja praktike, tregu shqiptar nuk është përballur me raste shoqërisht që dalin nga tregu apo i janë nënshtruar ndonjëri prej veprimeve të tjera, si administrim i përkohshëm apo transferim portofoli, si me miratim të AMF-së apo me vendim gjyqësor. Kjo situatë e bën edhe më të paqartë interpretimin dhe veprimin praktik të përcaktimeve ligjore, bashkërendimin e veprimeve ndërmjet autoriteteve të ndryshme, si dhe pozitën e konsumatorit. Në mënyrë ekziston rreziku që administrimi i një procesi të tillë t'i nënshtrohet interpretimeve, të cilat mund të mos jenë në harmoni dhe konsumatori jo detyrimisht të ketë trajtimin e preferuar, veçanërisht po të mbajmë parasysh edhe përvojën me trajtimin e konsumatorit-viktimë në rastin e administrimit të fondit të kompensimit.
- Legjislacioni nuk vjen në përputhje me standardin ndërkombëtar në lidhje me ndërhyrjen e jashtëzakonshme.

Mbi bazën e këtyre përfundimeve, synimi është që legjislacioni shqiptar të pasqyrojë apo të përmbushë gjerësisht standardet ndërkombëtare. Në këtë aspekt rekomandohet:

- Përmirësimi i legjislacionit për falimentimin e shoqërive financiare duke rishikuar ligjin e falimentimit ose ligjin e fushës me synim plotësimin dhe harmonizimin e dispozitave ligjore, si dhe parashikimi i anëve procedurale në një kuadër rregullator të detajuar.
- Plotësimi i legjislacionit me mekanizmin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe këtu rezulton e përshtatshme ndjekja e modelit të Bankës së Shqipërisë, që nënkupton rregullim përmes një ligji të posaçëm.
- Ndërtimi i një kuadri të qartë për ndërhyrjen e jashtëzakonshme me mekanizmat e nevojshëm dhe skemë të qartë financimi, në linjë me praktikën më të mira ndërkombëtare. I gjithë ky kuadër duhet të mbështetet me aktet e nevojshme nënligjore, ku të jenë të përcaktuara qartë mekanizmat, procedurat dhe përgjegjësitë e palëve të përfshira në proces.

- Përcaktimi i autoritetit përgjegjës për ndërhyrjen e jashtëzakonshme, së bashku me ndërtimin e modaliteteve të financimit për këtë qëllim, me kompetenca të qarta ligjore, si dhe insitucionalizimi i strukturës që zbaton ndërhyrjen e jashtëzakonshme.
- Ndërtimi i mekanizmave të financimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe përcaktimi i qartë në ligj i momentit kur një shoqëri sigurimi nuk mund të vijojë më aktivitetin dhe është e destinuar të dalë nga tregu.
- Ndërtimi minimalisht i mekanizmave plotësues apo një skeme të qartë financimi për detyrimet që burojnë nga ligji i sigurimit të detyrueshëm kundrejt palëve të treta, në rastet e daljes nga tregu të një shoqërie sigurimi, anëtare e BSHS-së.

REFERENCA

Burime AMF

- <https://amf.gov.al/pdf/publikime2/mbikeqyrje/RaportiMbikeqyrjes2017.pdf>
- <https://amf.gov.al/statistika.asp?id=1&s=1&r=1>.
- <https://amf.gov.al/akte.asp?id=2&id2=2> Aktet nënligjore që trajtojnë çështjet e përkatëse të këtij raporti.

Burime të tjera

- Birds J., “Bird’s Modern Insurance Law”, Sweet & Maxwell, 1th Edition
- Bourgoignie Th., Komentari i Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit (2010).

Legjislacioni

- Kodi Civil.
- Kodi i Procedurës Civile
- Ligji nr. 10076, datë 12.02.2009, "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", i ndryshuar
- Ligji nr. 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit"
- Ligji nr. 9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”
- Ligji 110/2016, datë 27.10.2016 “Për falimentimin”
- Ligji 9121 datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”
- Ligji 133/2016 “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka”.
- Ligji 53/2014 “Për sigurimin e depozitave”.
- Ligji nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar
- Ligji nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar
- Ligji 133/2016 “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë”